



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



01 Nr. 05/21
Rahovec, 20.05.2021

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më
28 maj 2021 (e premte) me fillim në orën 10:00, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit për këmbimin e pronës publike komunale me pronë private P - 71510068– 02440-0 Ratkoc;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i plotësim ndryshimit të vendimit 01 Nr.180/21, i datës 29.03.2021 të planit lokal për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore;
6. Shqyrtimi dhe aprovimi plotësim ndryshimit të vendimit 01 Nr. 181/21, i datës 29.03.2021 të planit lokal për menaxhimin e mbeturinave të vëllimshme;
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Plotësim ndryshimit të Rregullores për vendosjen e objekteve të përkohshme në territorin e komunës së Rahovecit 01 Nr.2558 të datës 27.06.2024;
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr.189/21, të datës 29.04.2021;
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr.190/21, të datës 29.04.2021;
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr.191/21, të datës 29.04.2021;
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr.192/21, të datës 29.04.2021;
12. Informatë nga DSHPS-ja rreth pandemisë Covid-19;
13. Informatë nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për periudhën janar- prill;





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.04.2021**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t’iu përshëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z. **Smajl Latifi**, nënkryetar i Komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të LMT-së, përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm! Në këtë mbledhje të rregullt kemi edhe anëtarin e ri të Kuvendit z. **Kajtaž Berisha** nga radhët e PDK-së, te cilin e ftojë që të ngritet në këmbë dhe të bëjë betimin e kuvendarit.

Kajtaž Berisha – Unë, **KAJTAZ BERISHA**, “Betohe me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do të ushroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Rahovecit, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë.

Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë:

REND DITE

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,**
- 3. Shqyrtimi i raportit financiar janar–mars 2021,**
- 4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për bartjen e rezervave të investimeve kapitale të vitit 2021,**
- 5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P – 05864 – 0 Rahovec,**
- 6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P – 07111 – 1 Rahovec,**
- 7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P – 02352 – 0 Rahovec,**

8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës se paluajtshme në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P – 00251 – 0 Çifllak,
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për vënien në debat publik të Draft Strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal për Komunën e Rahovecit 2021 – 2025,
10. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Punës së Komitetit të Auditimit për vitin 2020.

Sali Sallteku – Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë po dua me ndërhy te rendi i ditës pasi propozimi im është që pikat 5,6,7 dhe 8 duhet të largohen nga rendi i ditës pasi që pas muajit maj me sa e di unë kryetari nuk ka të drejtë në aspektin ligjor dhe të mos merret me këto pika, por në momentin kur vjen kryetari i ri të merret me këto punë. Kështu që këtë propozim timin mundësisht me qitë ne votim pasi unë e di se nuk ka të drejtë ligjore me dhënë prona 6 muaj para zgjedhjeve.

Fehmi Hoxha– Përshëndetje për ju kryesues, kryetar, nënkryetar, kolegë kuvendarë, drejtorë të ekzekutivit, media dhe gjithë të pranishëm. Unë plotësisht pajtohem me propozimin e z. Sallteku, pasi që ne kemi marr këtë material mirëpo këtij materiali për këto katër pikat kërkoj që te kalojnë në seanca tjera dhe pasi që te merret një raport nga inspektorati eventualisht nga drejtoria e bujqësisë dhe drejtoria për inspeksion dhe aktualisht se kush po i shfrytëzon ato prona dhe ku gjenden ato. Pra duhet të sjellët një raport dhe më pas të procedohet kjo në seanca tjera. Kështu që sinqerisht nuk është mirë kjo dhe faktikisht ata që po e shfrytëzojnë edhe po ju japim prapë atyre, pasi shkruhet se për interes te qytetarëve por në fakt është interes individual. Pra, duhet të sjellët një raport të qartë pasi kuvendarët duhet ta dinë se kush po i shfrytëzon ato prona aktualisht, prandaj unë e mbështes dhe kërkoj dhe i bashkëngjitem kërkesës se z. Sallteku që këto katër pika të rendit të ditës të largohen për këtë seancë. Siç e potencoj edhe z. Sallteku nga muaji maj fillon edhe 6-mujori, që nuk kemi te drejtë edhe tani pastaj nëse i japim procedurat do të vonohen dhe nuk do të kaloj ashtu si duhet dhe do të kthehet dhe nuk do të certifikohet. Unë kam edhe një propozim tjetër tek pika e katërt, shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për bartjen e rezervave të investimeve kapitale në vitin 2021, me gjithë respektin që kam ndaj drejtorit me siguri këtu ka qenë ndonjë gabim pasi që këtu nuk është propozim vendim i kryetarit sepse është vetëm propozim i drejtorit që ka shkuar te kryetari, që në parim jam për me i votua por këtu nuk ka propozim vendim i kryetarit dhe në këtë dokument duhet me pas propozim vendim të kryetarit e jo të drejtorit, pasi ligjërisht kryetari duhet me bo propozim. Prandaj këto pika duhet ti shtyjme për në fund dhe në ndërkohe propozim vendimi të përgatitet nga sekretaria dhe të ju jepet të gjithëve për me pas, pasi ju jeni përgjegjës kryetar për me i pas këto.

Kryetari – Përshëndetje për kryesuesin e kuvendit, nënkryetarin e komunës, anëtarët e kuvendit, drejtorët e drejtorive, përfaqësues te mediave, gjithashtu përshëndetje për anëtarin e ri të kuvendit z. Kajtaž Berisha dhe ju uroj suksese më tutje. Unë e dëgjova me vëmendje të dy shqetësimet të cilat i ngritën Sali Sallteku dhe Fehmi Hoxha dhe besoj se nuk është shaka që Vjosa Osmani është presidente e Republikës se Kosovës dhe nuk e ka caktuar datën e zgjedhjeve. Kështu që pa u caktue data e zgjedhjeve, kuvendi i komunës edhe kryetari i komunës i ka të gjitha përgjegjësitë të cilat i ka për detyrë me i ushtruar. Pra, besoj që nuk po bëj shaka pasi të gjitha komunat janë duke u provuar kështu dhe ndoshta nesër e cakton datën e zgjedhjeve. Kështu që përderisa nuk e kemi të konfirmuar zyrtarisht datën e zgjedhjeve ose dekretin e presidentes në këtë rast, atëherë ne kemi te drejtë me vendos për këto pika te rendit te ditës te cilat i theksuat ju por më shumë i detajizoi Fehmi Hoxha. Sa i takon raportit se çka bëhet me këto toka, normalisht se unë jam dakord që në mbledhjen e ardhshme me ju sjellë informatat e sakta. Por sa i takon këtyre pikave që tokat bujqësore nuk i merr ndonjë kooperativë bujqësore pasi që vetëm një është në Krushë të Madhe edhe nuk ka të tjera por përfitues janë individët të cilët i përfitojnë ato sipërfaqe apo i marrin në shfrytëzim në bazë të vlerësimit të një komisioni të cilin e ka miratuar kuvendi i komunës së Rahovecit. Po flasim për mandatin që unë jam dhe ne jemi të interesuar që bashkë me

kuvendin me i parë edhe ato toka që janë dhënë edhe në mandate tjera se a janë shfrytëzuar dhe a janë përdorur për qëllime të caktuara apo tjera. Por, sidoqoftë unë i kërkoj drejtorit të Bujqësisë që të sjell një raport pasi kryesisht janë për toka bujqësore, pra një raport apo informatë se cila është gjendja aktuale e tokave të cilat i kanë përfituar për ti shfrytëzuar personat fizik apo juridik, pra janë persona e nuk janë organizata pasi ju po e dini se tash jemi në kapitalizëm edhe nuk kemi të bëjmë më me sistemin e kooperativave, pasi edhe kooperativat janë të organizuara më ndryshe në bazë të një ligji. Pra, jemi për me mbet këto pika dhe jemi për me prit ligjshmërinë e këtyre pikave dhe në momentin që ata na konfirmojnë ndryshe, atëherë normalisht ne prapë jemi këtu. Por nuk është çështja që ne guxojmë me lanë pika të rendit të ditës pa i qitë në kuvend të komunës, nëse ka situata që ne duhet me i trajtuar si qeveri si kryetar bashkë me kuvendin e komunës. Pra, jam për me mbet këto pika dhe gjithashtu jam për me pas një informatë për gjendjen e këtyre tokave të dhëna në shfrytëzim edhe për me pas një pasqyrë me debatue bashkë se çka do të veprohet sipas ligjit nëse ka eventualisht ndonjë keq shfrytëzim ose mungesë aktiviteti ne ato toka apo prona që i kanë marr te tjerët me vendim të komisionit që është kryesisht i kuvendit edhe me përfaqësuesit e qeverisë në bazë të ankandit publik. Kështu që nuk kemi vendim që për mos me dhanë toka në shfrytëzim dhe deri sa te jem kryetar i komunës krejt çka më lejohet me ligj, unë do të jap toka në shfrytëzim por sigurisht se ne e zbatojmë ligjin dhe nëse nuk ju pëlqen atëherë mundeni me bo vërejtje dhe unë jam kryetar i komunës dhe kam mandat që realisht kuvendi mundet me thanë ndryshe dhe këtë e kuptoj dhe krejt ne rregull jemi por Fehmi Hoxha e din që e kemi prit e ndoshta edhe në fillim te prillit kam prit atë ju e thoni por nuk na ka ardhë që ndoshta është vonesë edhe nga ndërrimi I qeverisë e pastaj zgjedhja e presidentit, por në asnjë komunë nuk i ka shkuar ndonjë vendim që janë të suspenduar nga marrja e vendimeve. Prandaj jam për, dhe duhet të vazhdohet sepse munden auditoret apo monitoruesit munden me na than se pse nuk e keni shtie në raport apo nuk po i trajtoni këto problematika që realisht janë punë kryetarit të komunës dhe gjithashtu edhe te kuvendit të komunës. Po ashtu pajtohem edhe me atë që tha z. Fehmi Hoxha që propozim vendimi është I kryetarit, pra nuk ka nevojë me u shty pika dhe kërkoj mirëkuptimin tuaj se me siguri është gabim teknik dhe vërtet çuditem se si ka ndodhë, pasi që punën me të madhe e ka bo drejtori i Financave por propozim vendimin sipas procedurave është i kryetarit të komunës. Kështu që jam dakord me te gjitha ato çka thatë ju por mirë është me mbete ne rend te ditës këto pika dhe ndoshta ligjshmëria edhe 4 muaj nuk zgjatë apo nuk fillon hiq. Por ne në kuvend te komunës mundemi me i krye sepse kemi te drejtën ligjore dhe kompetente me i krye deri sa nuk kemi asnjë konfirmim apo vendim ndryshe nga presidenti. Kështu që besoj se jemi ne rregull pasi edhe ne mandatin e kaluar janë dhanë prona por tash duhet me i këqyr vërtet se a po shfrytëzohen mire apo jo, por e vërteta është se jan dhënë pasi që për atë punë janë që me u shfrytëzue mirë e drejtë e sidomos tokat bujqësore.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar, tek pjesa e bartjes se mjeteve rezervë, na ka ardhë si pikë kërkesë ne mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa edhe sigurisht se do ta rregullojmë këtë propozim vendim prej kryetarit. Po ashtu kryetari e shpjegoj edhe tek ligji për vetëqeverisje lokale ku është e shënuar edhe paragrafi që ne momentin që presidenti i vendit i shpall zgjedhjet atëherë prej atij momenti nuk kemi te drejtë.

Sali Sallteku – Nuk po dua te replikoj me kryetarin, mirëpo unë thash atë çka thot ligji dhe kur e shpall presidentja nuk e di, por e di që pas 6-muajve nuk ka të drejtë të jepet në nivel komune. Ndoshta presidentja mund te del me propozim pas një jave por kur të vjen afati optimal brenda 6 muajve atëherë nuk ka të drejtë kryetari me dhanë. Pastaj siç e thatë ju që drejtori me dhanë raport atëherë megjithatë pasi të votojmë nuk kemi nevojë me dhanë raport. Kështu që ne po kërkojmë që për këto katër pika kërkojmë raport nga drejtori.

Kryetari – Tash ne momentin që hynë këto në rend të ditës, jepet raporti dhe bisedohet se për cilat toka bëhet fjalë. Kështu që me se pari duhet me u marr vendimi ne kuvend te komunës se a dëshirojmë me i dhanë për 5,10 apo 14 vjet dhe pastaj mbi bazën e këtij vendimi kuvendi shpalli ankandin ne përputhje me vendimin e kuvendit. Pra unë jam për me dhanë raport për ata që i kanë pronat, kështu e kuptova unë. Kështu që ne nuk e dimë se kush i merr këto prona përmes ankandit, pasi tash janë vetëm kërkesa.

Fehmi Hoxha – Faleminderit kryesues, unë isha i qartë mirëpo si duket ju nuk me keni kuptuar dhe po me pëlqen ajo që thatë me herët që duhet me marr raport edhe për te gjitha pronat që janë dhënë, edhe po e marrim si propozimin tuaj që edhe ekipi juaj duhet me na dhanë një raport dhe po me pëlqen propozimi juaj. Mirëpo

unë kërkova për këto pika aktualisht kush po i shfrytëzon këto toka që po dëshirojmë me i dhanë na aktualisht, pra raporti nga drejtorja e bujqësisë dhe drejtorja e inspektoriatit se kush po i shfrytëzon aktualisht dhe me këtë raport kur të na vjen komplet ky material pasi ju thoni mundet edhe në seancën e radhës atëherë të kalojnë komplet këto pika në seancën e radhës me raportin në detaje se kush po i shfrytëzon. Prandaj e mbështes propozimin e Sali Sallteku, që të qitet ne votim që këto katër pika të largohen për sot dhe të sjellën për seancën e radhës me raport se kush po i shfrytëzon.

Kryetari – Nuk po dëshiroj me bo replikë, por ideja është është që ju Fehmi Hoxha e kuptoni me mirë procedurën edhe e njeh këtë problematikë edhe më mirë se unë. Nuk ka mundësi që kryetari i Komunës me i kërkua kuvendit të komunës që miratojmë vendime për me i shpallë ne ankand pronat të cilat kanë paqartësi. Por për këto pika saktësisht mundet me fol drejtori i gjeodezisë dhe i bujqësisë tash dhe pikërisht duhet me u dhanë ne ankand me u shfrytëzue e ndoshta edhe me i eliminua sepse e bëjmë njëfarë mbrojtje kur kuvendi i komunës përmes ankandit i jep një përfituesi që e ka të qartë dhe është pastruar që mundet me qenë ndonjë kontest se kush mundet me shfrytëzue. Pra gjendja kadastrale në këtë rast është e pastër prandaj ne nuk mundemi me i lanë ne mëshirën e ndonjë keqpërdoruesi të mundshëm, potencial nuk do të thotë që ka sepse gjendja është e pastër. Por pikërisht kuvendi i komunës dhe kryetari i komunës bashkë me ekzekutivin i jep një qartësi për çfardo tendencë që me bo, sepse ne jemi kontrollor të kësaj pune pasi ne e marrim vendimin për kohëzgjatje dhe për me shpall ankandin publik që dritë jeshile i jep kuvendi i komunës dhe pastaj nga ankandi shihet me se miri nëse dikush e ka ndonjë stallë apo diçka tjetër dhe menjëherë aty përfituesi e ka ndihmën e ligjit që i rrin mbrapa kësaj pune. Pra edhe nëse ka këso probleme atëherë ne nuk duhet me lejua këtë edhe me lan për seancën tjetër mundem edhe me u grumbullua gjithë këto pika edhe mundemi me pas edhe vërejtje rreth pikave që munden me u grumbullue për kuvendin e komunës edhe pse nuk keni vepruar. Kështu që unë po veproj në përputhje me kompetencat dhe në momentin që më vjen vendimi atëherë edhe mund ta shqyrtojmë edhe këtë mirëpo ne e marrim sot vendimin edhe realisht jemi në përputhje të plotë me ligjin edhe sigurisht në përputhje të plotë atë që po e kërkoni ju z. Hoxha sepse drejtoret Afrim Oruçi dhe Berat Duraku kur te vijne për secilën pikë kanë me fol rreth këtyre pikave pasi kanë dokumente ortofoto dhe shihet gjithçka nga ortofoto se a ka ndonjë ndërhyrje ne ato prona. Pra unë jam në përputhje me ligjin dhe po kërkoi që me qenë sa me saktë këto që i themi. Plotësisht jam dakord me kërkesat e tua Fehmi Hoxha që po kërkoni edhe sigurisht edhe për ata që kanë qenë pronar apo janë shfrytëzues prej vitit 2009 dhe sigurisht ne kemi shqetësim pasi janë edhe faktor tjerë që janë përzier si agjencioni pyjor e plot tjerë, që realisht nuk jemi të sigurt se a përdoren me së miri ato prona, pasi e ka marr për vreshta kurse e ka shfrytëzuar krejt për diçka tjetër, kështu duhet me shikua edhe njëherë si qëndron çështja e atyre pronave.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, përshëndetje për juve, kryetarin, nënkryetarin, drejtorët, kolegë këshilltarët, media dhe gjithë të pranishmit në sallë, po ashtu këshilltarit të ri z.Kajtaç Berisha i urojmë shëndet, punë të mbarë dhe suksese në detyrën e re. Kur jemi të ky propozim që u dha që të shtyhen këto pika të rendit të ditës 5,6,7 dhe 8 për arsyet që u përmenden me herët, unë mendoj se me vjen keq që nuk është bërë ndonjë konsultë të kësaj çështje pak me gjerë dhe pastaj ne si Komitet për Politikë dhe Financa e kemi shqyrtuar këtë rend dite me këto pika dhe nuk kemi pasur ndonjë vërejtje apo kundërshtim. Kështu që mendoj se kemi të bëjmë me dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim qytetarëve që i kemi dhënë edhe më përpara dhe nuk kemi pasur vërejtje ndonjëherë tjetër, kështu që unë shkurt pa e zgjatur me shumë propozoj që këto pika të mbeten në rendin e ditës dhe ne do të shqyrtojmë edhe ashtu për çdo pikë dhe ne mundemi me i aprovue apo me i refuzuar. Pra kuvendi le të vendos, pasi ajo periudha kohore tash është diskutabile siç u tha me herët rreth ligjit para 6-muajve sa është, por sidoqoftë unë mendoj se kjo nuk është diçka problematike e madhe që mundet me u bo dhe prapë ne jemi ata që vendosim, kështu që unë kërkoi mirëkuptim prej kolegëve dhe mendoj që duhet të shkoj kështu që të mbeten këto pika të rendit të ditës.

Rasim Fazliu – Përshëndetje kryesues për juve, kryetarin e komunës, nënkryetarin, anëtarët e kuvendit, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë i dëgjova me vëmendje kolegët për mendimet e dhëna, siç e tha edhe parafolësi që në KPF i kemi trajtuar këto tema edhe i kemi kaluar për kuvend. Ajo që unë dua të them është përderisa neve si kuvend por edhe ekzekutivin nuk e kufizon

ligji dhe nuk vjen një vendim që nga sot tregon se jeni jo funksional, unë konsideroj se ne si kuvend jemi ne punë dhe duhet te punojmë dhe puna jonë është kjo që t'i trajtojmë pikat e rendit të ditës që na vinë dhe siç e tha edhe doktori që mundemi me i miratua edhe mos me i miratua, por, në fakt ne jemi ende funksional edhe duhet me i trajtua temat që na vinë dhe ky është mendimi im personal dhe nuk kam qejf me pas polarizime dhe për mendimin tim është e logjikshme që temat duhet me u trajtua dhe ne jemi këtu për me punua. Por, nëse ka diçka që është e kundërligjshme atëherë janë organet e caktuara që e refuzojnë atë dhe e kthejnë organet kompetente mirëpo ne duhet ta bëjmë punën tonë që me diskutua për ato probleme dhe gjë tjetër që u tha për prona që me kërkua përgjegjësi apo llogari, do të ishte mirë që çdo herë që edhe pa i kërkua anëtarët e kuvendit do te ishte mirë me dhanë raporte që me pa si është gjendja që a po shfrytëzohen apo nuk po shfrytëzohen. Por një gjë e di që ai që e ka marr për vreshtë dhe ka mbjellë diçka tjetër, unë mendoj se mirë ka bërë pasi më mirë është që të paktën ka punuar diçka se sa me lanë djerrinë dhe nuk kisha me thanë që mund të quhet kjo keqpërdorim pasi për mua keqpërdorim është nëse e merr edhe nuk e shfrytëzon dhe rritet bari aty. Kështu që përndryshe është mirë që të mirëkuptohemi dhe meqenëse thashë dhe më herët se i kemi trajtuar edhe në KPF dhe i kemi përcjell për kuvend atëherë kuvendi është ai që vendos dhe ky është mendimi im personal dhe nuk është i grupit dhe i ftoj edhe kolegët që të reflektojnë sepse kemi të bëjmë me një kuvend legjitim dhe jemi aktual dhe në momentin kur na kalon mandati sigurisht që pastaj e shohim dhe nuk mund të marrim vendime por përderisa kemi mundësi me bo diçka do të ishte mirë me punua për qytetarët e komunës se Rahovecit.

Kryesuesi – Faleminderit z. Fazliu për sqarimin, të nderuar kolege kuvendarë besoj që u sqaruan te gjitha edhe propozimi i z. Hoxha dhe jemi në vijë me ligjin edhe sigurisht se na dërgojnë ftesën presidencia. Shume për kontributin dhe sidoqoftë mirë është që jemi sqaruar. Atëherë me kërkesën e z. Sallteku e qesim ne votim propozimin për heqjen pikave nga rendi i ditës. Konstatoj se me 11 vota pro aprovohet që këto pika te mbesin ne rend te ditës. Tani e qesim ne votim rendin e ditës. Konstatoj se me 15 vota pro, 1 kundër dhe apstenim nuk kemi, aprovohet rendi i ditës. Kalojmë ne pikën e parë te rendit te ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush diçka sa i përket procesverbalit?

Ali Morina – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtor te drejtorive, kolegë asamblistë. Me lejoni që në emër te grupit të AAK-së, të i urojmë sukses kolegut z. Kajtaç Berisha dhe ti urojmë punë te mbarë. Vërejtja ime tek procesverbali është faqe 12, aty ku kam diskutuar unë, ne rreshtin e parë kam thënë që në funksion të dhënies së kontributit për këtë çështje ndërsa në procesverbal figuron në funksion të grupit për këtë çështje d.m.th. është e pakuptimtë me atë që kam thënë në funksion të dhënies së kontributit për këtë çështje, kështu që shpresoj që ky gabim te përmirësohet.

Atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, e qesim ne votim pikën e parë te rendit te ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e dytë te rendit te ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet ne pyetjet e kuvendarëve.

Masar Popaj – Përshëndetje kryesues, nënkryetar, drejtor te drejtorive, asamblistë dhe gjithë ju te pranishëm. Fillimisht dua te ju falënderoj për punën e bërë deri me tani për ndriçimin e ri publik ne fshatin Fortesë e posaçërisht dua te falënderoj drejtorin e drejtorisë se Shërbimeve Publike z. Përparim Krasniqi për angazhimin ne përfundimin e këtij investimi. Gjithashtu dua te potencoj se nuk është i mbuluar i tërë fshati pra një pjesë e konsiderueshme e tij respektivisht lagjet Gashi dhe Berisha si rruga Fadil Gashi ku ka ankesa dhe kërkesa te vazhdueshme nga banoret e asaj lagje te cilët ndihen te diskriminuar. Kështu që a mundeni me na tregua se kur parashihet të kryhet ndriçimi edhe në atë pjesë të fshatit. Ndërsa çështje tjetër që doja te shtoja ka lidhje me operatorin Ekoregjioni ndaj te cilit ka ankesa te shumta ne lidhje me situatën e krijuar pas lëshimit te bërë nga ju si fshatrat Xerxe, Fortesë por sigurisht edhe qyteti kanë hasur ne telashe ne lidhje me parapagimet e bëra ndaj operatorit Ekodrinia e të cilat pagesa po i kërkon operatori i tanishëm Ekoregjioni. Kështu që a mundeni të na tregoni se si e parashihni të zgjidhni këtë situatë. Po ashtu në lidhje me fshatin Fortesë sa i përket lumit

rreth lutjeve dhe kërkesave të parashtruara për rregullimin e shtratit të tij, e shoh se keni filluar mbarë por uroj dhe shpresoj që ju i nderuari kryetar të shkoni deri në fund këtë proces, pasi pengesat keni filluar të i mënjanoi por uroj edhe në pjesët e tjera përgjatë lumit mundësisht të mënjanoi.

Rexhep Oruqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju, nënkryetarin dhe gjithë të pranishmit në sallë, gjithashtu edhe z. Kajtazi i dëshiroj urime dhe suksese në punë. Edhe unë po potencoj një çështje që ma merr mendja që është shumë me rëndësi, pra fjala është për stacionin e autobusëve në Rahovec dhe flas në emër të anëtarit të komisionit të aksionareve, pasi që ky kuvend me vendim e ka zgjedh anëtarët e aksionareve edhe jemi të obliguar me njoftua kuvendin me gjendjen aktuale që është në stacionin e autobusëve. Unë propozoj që në mbledhjen e radhës të kuvendit të përcaktohet si pike e veçantë rreth gjendjes aktuale në stacionin e autobusëve sepse nuk qëndron gjendja e mirë financiare edhe pse janë bërë investime nga ekzekutivi i komunës por megjithatë janë disa gjëra që nuk po shkojnë në rrugën e duhur. E para propozoj që mos me prit seancën e radhës se kuvendit por urgjentisht të vihet një vendim por edhe duhet në seancën e radhës sepse me herët nuk do të kemi mundësi që me u bë bartja në shfrytëzim të 3 objekteve që i kanë në kuadër të stacionit të autobusëve. Pasi është jo logjike që komuna të shfrytëzojë qiranë për ato objekte kurse veçse e kemi bartur pronën në tërësi kurse 3 lokale janë brenda stacionit e komuna po i shfrytëzon qiranë prej atyre 3 objekteve. Pastaj propozimi i dytë shpallja e ankandit publik për restorantin që ka brenda stacionit, pasi ka mbi 4 muaj që nuk shfrytëzohet qiraja prandaj duhet urgjentisht që me shpall në ankand, kështu që a e shpallim na si komision i aksionareve apo bordi i tyre atëherë është çështje për diskutim që realisht është zyra ligjore që duhet të konsultohet rreth kësaj. Pra duhet një komision ky kuvend me formua për shlyerjen apo riprogramimin e borxheve të tyre sepse janë mbi 100,000 euro borxhe dhe i kanoset rreziku që mundet në çdo moment të bllokohet llogaria dhe pastaj ata nuk mundet me funksionua ashtu si duhet. Kështu që besoj që janë disa gjëra që nuk duhet me prit kuvendin e radhës por janë edhe disa gjëra që duhet në kuvend me i diskutue dhe me i debatue rreth raportit të punës dhe njeherit edhe vihet vendimi për bartjen në shfrytëzim të këtyre objekteve që janë në kuadër të stacionit të autobusëve.

Ali Morina – Faleminderit kryesues, unë desha me ngritë një çështje mjaft të rëndësishme për qytetarët e komunës së Rahovecit, pasi drejtorja e shërbimeve publike po vazhdon të bëjë një punë të mrekullueshme në gjithë territorin e komunës së Rahovecit në të gjitha sektorët qoftë në ndriçim, në rrugë, në trotuare dhe në bashkëbisedim me drejtorin kemi biseduar për mundësinë e vazhdimin të shtrimit të trotuareve dhe jam informuar se është në pritje të hapjes së tenderit për nënshkrimin e një kontrate të re. Unë desha me pyet se deri ku ka shkuar kjo procedure duke marr parasysh kërkesat e shumta të qytetarëve të zonës së anadrinit qoftë mes fshatit Ratkoc dhe Dejnë apo Ratkoc dhe Malësi e Vogël. Por është një shqetësim tjetër që është trotuari nga qendra e fshatit Ratkoc e deri të shkolla e mesme nuk është i përfunduar i tëri dhe ka mbetur në gjysmë, kështu që shpresoj që në këtë kontratë të përfshihet edhe kjo pjesë që ka mbetur në gjysmë që të vazhdohet deri të shkolla e mesme që të ju ofrojmë siguri me të madhe nxënësve.

Fehmi Hoxha – Kryetar nëse ju kujtohet miratimi i buxhetit atëherë që po përsëris për disa herë, keni dhënë premtimin për me rregullua kanalizimin fekal dhe atmosferik të rrugës Fahredin Hoxha, kështu që pos që ka dal drejtori me një ekip në vendin e ngjarjes nuk ka asnjë veprim tjetër nuk ka. Më intereson me ditë se a ka buxhet për këtë rregullim, a do të fillon sivjet ky premtim i juaji, kështu që kërkoj edhe njëherë që drejtori apo kryetari të na jep përgjigje rreth kësaj pasi është kërkesë e madhe dhe është në qendër të qytetit dhe vazhdimisht kundërmon erë e keqe dhe një shi i vogël edhe gjithçka del jashtë dhe vërtet kërkon intervenim urgjent. Pastaj pyetja e dytë përsëri ka të bëjë për drejtorin e shërbimeve publike, kështu që si anëtar i kuvendit kanë kërkuar nga unë dhe me kanë ftuar edhe me telefon kanë kërkuar qytetarët dhe banorët e lagjes të segmentit rrugor Xhelal Hajda – Toni ku rregullohet kanalizimi atmosferik, e dimë që është punuar mirë edhe gjatë dimrit mirëpo nuk e di pse tash ngjehet puna dhe ka vonesa shumë pasi siç e dimë gjithë kanë probleme

shumë të gjitha bizneset e atij segmenti rrugor. Kështu që nëse ju kujtohet që kam dhënë propozim që të subvencionohen të gjitha bizneset me nga 1000 euro pasi vërtet këto biznese kanë humbur shumë si dhe në aksin rrugor në Fortesë siç e dimë atje është edhe më keq gjendja se këtu, ku fatkeqësisht operatori jo i mirë gjë që edhe ju e keni shpreh zyrtarisht. Kështu që ju lusë që nëse ka nevojë edhe ti ndajmë edhe mjetet pasi e di që i keni borxhe edhe kompanisë edhe të bisedoni me kompaninë që të rregullohet sa me shpejt ajo pjesë e rrugës Xhelal Hajda. Pasi në kuadër të rregullimit tani ka mbetur edhe asfalti kështu që ju lusë edhe njëherë që ta zbatoni planin e mobilitetit në atë aks rrugor dhe në bazë të planit të mobilitetit i cili është i votuar në kuvend komunal në mandatin e kaluar të vendimmarrjes, plani është në fuqi dhe është e paraparë vendndalimet për automjete por siç i pash unë ndërtimet që bëhen nëpër trotuare, atëherë nuk keni paraparë ato vendndalime. Pra, është shumë e rëndësishme me zbatua planin e mobilitetit sepse kuvendi ka sjellë ose vëjeni atë plan që ta shfuqizojmë përndryshe deri sa është në fuqi atëherë edhe duhet me zbatua, pasi në disa vende janë paraparë vendndalimet për vetura.

Shqipe Kryeziu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, i adresohem drejtorit të shërbimeve publike mirëpo unë nuk dua të lavdëroj punën e tij sikur kolegu Masar, pasi që rrugën Fadil Gashi në Fortesë ata banorë aty nuk e meritojnë me pas ndriçim publik apo nuk i konsideroni si qytetar të komunës së Rahovecit edhe ashtu ai ndriçim që është bërë nuk është për lëvdatë por megjithatë keni investuar diçka.

Ali Zhuniqi – Përshëndetje për të gjithë, unë desha të ndalem pak të arsyeja e votës kundër sepse kishte një reagim nga Rukija, kështu që arsyeja e votës kundër është që ne kemi qëndrimet tona dhe ju nuk mundeni me ndërhy në momentin kur kemi konsultë në raport me vendimet që duam me i marr si subjekt politik. Pastaj kur ne kemi kërkuar edhe ne muajt paraprak që me pas një raport të personave të cilët janë në shfrytëzim qofshin ata juridik apo fizik edhe me i pa na që kush i shfrytëzon dhe kjo është arsyeja e votës kundër e jo pse ata kërkuan që na duhet me u tërheq prej pikave të rendit të ditës. Kështu që duke pasur parasysh se jemi në fund të mandatit, kërkoj prej komisionit për vlerësim i cili është për dhënien e shfrytëzimit të pronave me përgatit një raport i cili është që nga viti 2017 dhe deri me tani, se kush janë personat që kanë përfitua në kuadër të këtij shfrytëzimi. Sa i përket ndriçimit publik krejt në rregull Masari që e adresoj si problem por pikërisht Masari ka qenë i pranishëm në momentin e prerjes së shiritit bashkë me kryetarin dhe nuk e di tash si ka mundësi me u pre shiriti e me pastaj me ardhur kërkesa. Kështu që u deshtë me bo kërkesën kur është prerë shiriti dhe para se me u përrua e jo tash me kërkuar diçka kur bashkë me kryetarin e keni pre shiritin.

Sali Sallteku – Faleminderit kryesues, unë kam një kërkesë për kryetarin e komunës, tash që u bo elektrifikimi në fshatin Gexhë ka mbetur afërsisht 300 metra për tu lidhur me fshatin Malësi e Vogel, kështu që kisha kërkuar nga kryetari që me krye edhe këtë pasi do të ishte mirë pasi është kërkesë e shumë banorëve sepse ka restorante hotele, pompa të derivateve, kështu që mendoj që keni mundësi me krye edhe këtë që me u lidh fshatin Malësi e Vogel. Edhe në fund e falënderoj vetëvendosjen për përkrahjen por jo Rasim Fazliun.

Rukije Krasniqi - Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Unë desha me bo një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike lidhur me kubëzimet e rrugëve, ku një rrugë në fshatin Krushë e Madhe ka mbi 3 muaj që ka filluar me u rregullua edhe ka mbetur ashtu, kështu që me intereson me ditë që deri në fund të mandatit a kryhet ajo rrugë pasi është kërkesë e lagjes që janë në atë rrugë. Gjithashtu edhe për drejtorin e bujqësisë kam një pyetje, a janë shpërndarë serrat të gjitha ato që janë planifikuar?

Kryetari – Faleminderit për angazhimin dhe shqetësimet që i keni ngritë, po filloj nga pyetja e parashtruar nga Rukije Krasniqi rreth rrugës në Krushë, unë mendoj se ajo do të kryhet kështu që mos e lidhni me mandatë këtë, por ka të bëjë me kushtet atmosferike pasi kompanitë nuk kanë punuar dhe situatën buxhetore që e kemi si komunë. Kështu që besoj që do të kryhet shumë shpejt sepse operatori do ta kryen këtë dhe me sa di unë është prioritet u vendos aty dhe sigurisht se kanë të drejtë këta tjerët me fol pasi që ende janë në proces me u krye disa rrugë dhe pikërisht në Krushë është ka punohet shumë sa i përket ndërtimet të rrugëve lokale dhe po besoj

që keni fjalën për rrugën që jetojnë edhe prindërit tuaj. Pastaj pyetjet e parashtruar rreth ndriçimit publik ne Fortesë, unë i kuptoj këto standardet e komunikimit prej Alisë dhe Masarit dhe gjithçka është ne rregull. Kështu që mund të ju them se ne kemi prioritet ndriçimin dhe është shume interesant se me shume ka kërkesa për ndriçim dhe është e vërtetë se lagjia e Gashëve ka mbetur dhe sigurisht se janë qytetare të këtij vendi dhe unë kam plot miq aty. Ka qenë një ide që me u lidhë me rrugën katër korsi sepse duhet një kuti tjetër elektrifikimi, pra është një situatë krejt tjetër për shkak të veprimeve që duhet me ndodh ne rrugën katër korsi. Dhe tash sot para se me fillua mbledhja patëm një takim me operatorin që a kemi mundësi me bo një zgjidhje me ndryshe që mos me krijua mendim të keq dikujt që po e harrojmë një lagje. Pra nuk është që ka qenë jashtë vëmendjes tonë por është një situatë që lidhet me punimet ne rrugën katër korsi ku edhe aty ka me pas ndriçim pra pjesa e rrugës rajonale, kështu që nuk ka arsye me mendua dikush që po bëjmë ndonjë dallim. Po ashtu kemi situata kur nuk kemi shtylla hiq dhe është lagje, kështu që nuk ke mundësi edhe me qitë ndriçim publik pasi duhet me qitë shtylla te reja pa pasur nevojë për germim. Pra janë disa pozicione që edhe neve po na shkaktojnë telashe ne terren. Projekti i ndriçimit publik vazhdon dhe mund të lidhet edhe ai segment por nuk ju premtoj që kjo do të ndodh shpejt do të bëhet sepse ka vende ku nuk ka drita hiq. Pra ju e keni parë që zona jonë ka filluar me u dukë me mirë dhe Fortesa, Xerxa, Krusha, Nagavci që ka ende për tu bërë sa i përket ndriçimit publik, gjithashtu edhe në qytet kemi disa segmente te vogla që realisht edhe aty jemi duke intervenuar, kështu që duhet me pa edhe zonën ku është ende pa ndriçim publik si Pataqan, Senoc, Pastasel, Polluzhë, Kramovik, Brestoc që kemi me filluar ne pjesën e rrugës që lidhet me Hoçë të Vogël, pastaj në Vrajak e Bratotin, pra, edhe ne këto pjesë do të bëhet lidhja por duhet me i këqyr edhe vende tjera që nuk kanë ende ndriçim publik. Te komisioni për dhënien në shfrytëzim, jam dakord krejt çka ka vendos kuvendi i komunës edhe komisioni për ankande i përcaktuar nga kuvendi i komunës prej vitit 2017-tës dhe jo vetëm nga 2017-të pasi edhe unë i kam dilemat e mia edhe pse nuk kam fakte se a po shfrytëzohen drejt apo jo, por kjo ndodh vetëm për raport për pronat komunale ndërsa për pronat e agjensionit pyjor sapo e pata edhe bisedë jashtë me Fehmin do ta kemi problem sepse ata spo na ofrojnë edhe dokumentacion kontratë p.sh. ti ja jep një vërtetim urbanistik dhe i thua se kjo zonë është ndërtimore kurse ai e shfrytëzon për bujqësi dhe nuk ju ka përmbajt vërtetimit sepse e ke për detyre me ja dhanë statusin e pronës dhe për çfarë nevoja mund të përdoret dhe tash ata agjencioni pyjor është autoritet vendimmarrës. Poashtu kemi kërkuar prej tyre dokumentacionet që edhe këto toka e agjencionit pyjor ku titullar është komuna që me këqyr se çka po ndodh, kështu do të mundohemi që me marr edhe atë informacion do te ishte shumë mirë, sepse e ka marrë për vresht edhe nuk ka bërë asgjë bile tash edhe e ka uzurpua për shkak se kontratën ja ka dhanë ai atje lartë dhe ne se kemi atë autoritet. Por sidoqoftë për mbledhjen e ardhshme për krejt çka kemi informacione zyrtare, komisioni i ankandeve do te del dhe do te ju informoj ashtu siç unë kam dal sot para jush, pasi komisioni i ankandeve i dhënies ne shfrytëzim janë ata që e sjellin informacionin dhe nëse un mundem me ju ndihmua diçka, po ju premtoj se nëse kanë bërë ndonjë shkelje edhe pse nuk besoj që ka pasi shkeljet i konstaton dikush tjetër dhe nëse ka dilema atëherë unë do ta lusë kuvendin e komunës që ta formojmë një komision që me pas mundësi me i monitorue se a po i shfrytëzojnë drejt ato punë. Te plani i mobilitetit, te kanali i ujërave atmosferik, pra kompania e cila kryen punimet ne terrene nuk e ka problemin tek mjetet edhe pse nuk i ka tash, por vonesat kanë ardhur edhe si rezultat kapak edhe i kohës keqe dhe keni pas mundësi që kanë punuar edhe ne kohe te keqe ndonjëherë që me dëshmuva se kemi qenë te detyruar ndonjëherë me punua edhe në kohe të vështira për me i krye ato punë. E kemi një problem me KED-sin për instalimet nëntokësore, që u deshtë me intervenua që me i dhanë shtytje problem për me bo zgjidhje sepse ata te lejojnë fillua punën mirëpo ata i kanë ato zgjidhjet teknike që e i bëjnë ne ato pusetat, por sigurisht që puna nuk do te ndalet pasi që do te behet shpejt rrafshimi dhe asfaltimi i rrugës dhe shenjzimi dhe tek në fund nëpër trotuar do te futen edhe 6 kablllo nëpër ata gypa që sigurisht se nuk do të pengojnë bizneset. Ne ju kemi ndihmuar atyre bizneseve me një shumë të caktuar pasi

siç e dini i kemi pasur 20,000 euro kështu që ju kemi ndihmuar me shumën 300, 350, 400 dhe 500 euro varësisht nga ajo që është konfirmuar përmes ARBK-së apo regjistrin, pra ato ishin mundësitë tona për 58 biznese realisht vendimi është marr dhe te gjithë kanë bërë kërkesa individuale dhe shqetësimi i tyre i vetëm është me mujtë me i krye punimet sa me shpejtë. Te plani i mobilitetit, ne kemi pasur një ide për krijimin e disa parkingjeve te reja, por, nuk është që mundemi me bo shumë zgjidhje pavarësisht planit të mobilitetit për shkak të situatës konkrete të cilën ne e kemi në terren, pra, gjendjen ekzistuese pasi që diku ka hapësirë dhe tash me bo një parking këtu për dy vetura dhe pas 300 metrave me bo edhe një parking tjetër për 5 vetura, nuk është që mundemi me bo një zgjidhje fatlume për këtë dhe ekziston mundësia më shumë me bo problem se sa me pas dobi për këtë dhe pikërisht problem me bizneset. Pasi për dëshirën time ajo rrugë do te ishte bërë katër korsi apo katër shirita dhe njëri shirit ne te dy anët me u përdor për parkingje por edhe aty duhet një punë e madhe mirëpo njëherë për njëherë duhet me bo këtë zgjidhje çfarë e kemi dhe shpresoj do te behet zgjidhje e mirë ne përputhje me gjendjen faktike ne terrene. Pastaj te rruga katër korsi, ne i kemi 3 operatore që realisht dy prej tyre janë te fortë siç është Euro-asfalti(Fetoshi) dhe kompania Mendi-P. Projekti financohet nga qeveria siç e dini dhe këta e kryejnë punën shume mire mirëpo kompania Victoria-Invest na ka krijuar situatë problematike që asnjëherë se kam fshehur, pasi e kam pasur ne takim të jashtëzakonshëm me pronarët e po ashtu edhe nga ministria dhe i kam kërkuar që asnjë punë nuk do ju pranohet pasi njëherë ska pagesë ai, mirëpo ai ka filluar përmirësimin e gabimeve në përputhje me rekomandimet që ja kanë dhënë dy kategori mbikëqyrshish, si mbikëqyrja e jashtme dhe mbikëqyrja që unë kam kërkuar enkas me pagesë për punë shtesë Sylejman Dakën. Tash kompania Victoria Invest e ka marr vet menaxhimin pasi ja ka marr atij nënkontraktuesit të vet, pasi dëshiron me rujt imazhin e kompanisë së vet, pasi ka krijuar imazh shume te dobët gjatë punëve te bëra. Pra, projekti financohet nga qeveria mirëpo autoritet kontraktues jemi ne. Tek segmenti i dytë prej Osa Termosistemit e deri ne hyrje te Rahovecit ka disa telashe me pronat, pasi janë disa biznese që nuk e kanë zbatuar kur e kanë bërë ndërtimin dhe e kemi bërë revidimin, pra standartin me ruajt por mundësisht me bo me funksional për biznese, kështu që tash besoj që edhe euroasfalti do te vazhdoj me intensitet punën. Pastaj pyetja e parashtruar për kanalizimin fekal dhe atmosferik, une mendoj se drejtori Perparim Krasniqi ju jep shpjegimin dhe nëse kanë filluar procedurat e prokurimit, që realisht sot po filluakan procedurat e prokurimit. Por mos harroni Fehmi Hoxha ai projekt që tash e kam parë, që kërkohet te bëhet me te gjitha zgjidhjet atëherë ka një kosto te madhe te financimit afërsisht mbi 80,000 euro, që me pas mundësi me i dhanë zgjidhje afatgjate te plotë edhe mirë është bërë që kemi filluar me procedurat e prokurimit dhe sigurisht që presim edhe kontratën. Poashtu edhe pyetja e parashtruar nag asambleisti Ali Zhuniqi rreth ndriçimit publik, që realisht ndriçim publik ne komunën e Rahovecit ka 100% vetëm ne fshatin Guri i Kuq, por pjesën me te madhe te ndriçimit publik ne vendbanimet kryesore, poashtu edhe ne fshatin Mrasor ka 100% ndriçim publik, poashtu edhe ne fshatin Dejnë ka 100% ndriçim publik mirpo edhe me pjesëmarrjen e komunitetit pasi vetëm rrugën kryesore e ka financua komuna. Kështu që unë nuk luftoj per gjysma pasi mundohem vet edhe sigurisht se ju tregova pse janë 80% e jo 100%,por nuk do të thotë që kemi harrue pasi tani keni me i pa edhe disa veprime që lidhen ndoshta edhe me lagjen Gashi sepse njerëzit profesionist di shumëçka pasi njëherë na kanë paraqit këtë problem se duhet te behet kështu apo ashtu dhe nuk e kemi lënë për asgjë tjetër dhe mundemi me pas edhe situata tjera që besoj që kur të del në postimin tjetër atëherë besoj që do te jemi ne rregull.

Sali Sallteku – Unë asnjëherë nuk kam kandiduar për kryetar te komunës por e di se mund të bëhem drejtor, po gjithashtu edhe një gjë e di se ju nuk do te jeni kryetar, kështu që nuk mora asnjë përgjigje, pasi Dejni me Dobidol janë te lidhura mes vete që janë në pyetje afërsisht 300 metra që keni mundësi me lidhë pasi edhe tani janë duke punuar aty dhe do te ishte mirë me krye këtë punë.

Kryetari – Nuk po dëshiroj me bo polemikë dhe as replikë por vetëm dua ti them Sali Sallteku që kuvendi i Komunës ka njerëz me të mençur se unë dhe si ti, kështu që prioritet i mesëm apo i ultë është lidhja mes vendbanimeve, por prioritet me i lartë është ai vend kur nuk ka drita hiq, kështu që unë në të ardhmen nëse të bëj drejtor të ndonjë drejtorie atëherë sigurisht se do ta shqyrtoj në të ardhmen.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar për të gjitha sqarimet, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Raportit financiar Janar – Mars 2021.

Afrim Limani – I nderuar kryesues, i nderuar nënkryetar, te nderuar asambleistë dhe gjithë ju të pranishëm, poashtu z.Kajtaç Berisha i urojmë mirëseardhje. Mirëpo raporti përbëhet prej të hyrave dhe shpenzimeve, ku të hyrat janë të paraqitura sipas muajve sipas kategorive ekonomike në mënyrë analitike ku gjithashtu janë të përfshira edhe gjjobat e gjykatave dhe trafikut gjithmonë me një krahasim me raportin e vitit të kaluar dhe planifikimit. Gjithashtu edhe shpenzimi i buxhetit është i paraqitur sipas kategorive dhe programeve kuptohet në krahasim me vitin e kaluar dhe planifikim si dhe të shprehura në përqindje. Të hyrat komunale në periudhën 3 mujore, të hyrat e rregullta janë një shumë prej 281,486 euro dhe nëse i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar atëherë kemi një ndryshim pozitiv në vlerë prej 36,975 euro. Te nderuar asambleiste, duhet ta keni parasysh që vitin e kaluar na ka goditë pandemia mirëpo efektet e saj janë shfaqur diku ka fundi i marsit dhe kjo nuk e ka pasur efektin që nuk ka reflektuar në të hyra dhe atëherë krahasimi i këtyre është në mënyrë reale kur bëjmë krahasimin me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar 2020. Pas mbledhjes së KPF-së na ka ardhur raporti nga gjjobat e trafikut por jo edhe nga gjjobat e gjykatave, kështu që gjjobat e trafikut janë në një shumë prej 69,984 euro e kur e bëjmë një krahasim në total të hyrat e rregullta bashkë me gjjobat e gjykatave atëherë kemi një ndryshim, atëherë buxheti në total bashkë me gjjobat e gjykatave për 3 muaj është 351,470 euro me një diferencë pozitive me një rritje simbolike prej 54,849 euro. Ndërsa shpenzimi i buxhetit për periudhën 3 mujore është në shumën prej 3 milion 897,000 euro kuptohet në të gjitha kategoritë duke përfshirë edhe kapitalet që të shprehura në përqindje është 27,42%. Shpenzimet kapitale kanë një përqindje të shpenzimeve prej 34,94%, subvencionet 39,43%, shpenzimet komunale 22,66%, mallra dhe shërbime 17,71% dhe pozicioni i pagave dhe mëditjeve 26,27%. Këto ishin të gjitha ato që i potencova në raport, kështu që pres ndonjë ndonjë përgjigje pasi nuk lash edhe hapësirë pasi pothuajse të gjitha i shpjegova.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për sqarimin tuaj, në kuadër të kësaj i kam dy pyetje edhe pse i kam adresuar edhe në kuadër të Komitetit për Politikë dhe Financa por e kam për obligim që edhe në kuvend të bëjmë një sqarim. Në faqe 9, kodi 14020 po ashtu në të njëjtën faqe kodi 14310 për dreka zyrtare, kisha kërkuar me na dhanë sqarim sa i përket këtyre dy kodeve.

Florida Bajraktari – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Meqë këtë pikë e kemi shqyrtuar edhe në KPF, mirëpo për hir të opinionit desha ta përsëris edhe njëherë këtë pyetje. Te faqe 5, krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike për vitet 2020 – 2021, te disa kode kemi ndryshime të mëdha p.sh. tek kodi 50009 taksa komunale për leje ndërtimi, realizimi për këtë 3 muaj për vitin 2020 ka qenë 542 kurse për vitin 2021 realizimi është 7967 euro, pastaj tek kodi 50026 taksë për legalizimin e objekteve, në vitin 2020 realizimi është 14,733 euro pra shumë më i madhe se në vitin 2021 kur realizimi në këtë 3 muaj është 2479 euro. Pra, do të ishte mirë që ta sqaroni se pse është ky ndryshim. Gjithashtu këtij raporti i mungon edhe buxhetimi gjinor që mendoj se është dashur me u shtua edhe kjo. Po ashtu në faqe 8 te kategoria mallra dhe shërbime, shpenzimi është i vogël i buxhetit për këtë 3 muaj, pra, buxheti sipas planifikimit ka qenë 1,715,477 euro ndërsa është shpenzuar 303,763 euro. Pra për të gjitha këto kërkoj sqarim.

Masar Popaj – Te shpërndarja e faturave të regjistrimeve dhe verifikimeve të objekteve në tatim pronë, unë kisha një vërejtje në faqe 6 te shpërndarja e faturës së tatimit në pronë sepse faturat nuk mbërrijnë me kohë dhe në adresë të duhur pasi shpesh ato lihen nëpër shitore apo kafiteri të vendbanimeve dhe tani kur komuna jonë ka emërtime të rrugëve numri i telefonit që në mënyrë që fatura e tatimit në pronë të mbërrin në adresën e pronarit. Pastaj tek mallrat dhe shërbimet kodi 13131 mëditja e udhëtimit zyrtar brenda vendit janë shpenzuar

6382.78 euro, kështu që më intereson me ditë se për çfarë mëditje bëhet fjalë brenda vendit. Edhe pasi që jemi te raporti financiar, më duhet të bëj një pyetje në lidhje me borxhin që ka komuna ndaj operatoreve ekonomik, qofshin borxhe ndaj kompanive që merren me investim kapitale si dhe ato shërbyese.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, fillimisht e falënderoj drejtorin për Financa për prezantimin e këtij raporti të 3 mujorit të parë të vitit 2021, edhe drejtori e tha edhe ne po e shohim në raport se të hyrat në periudhën 3 mujore të këtij viti në raport me vitin e kaluar ka shënuar rritje, gjithashtu edhe në raport me planifikimin ka rritje dhe ne i gëzohemi kësaj. Pastaj, edhe tek realizimi dhe planifikimi i tatimit në pronë gjithashtu po shihet se ka rritje edhe në raport me planifikimin edhe në raport me vitin e kaluar edhe pse ne i kemi vërejtjet tona edhe do t'i themi përsëri se kur është bërë planifikimi vjetor i buxhetit edhe atëherë e kemi cekur se buxheti është pak i ulët mirëpo janë ato standardet që e kanë përcaktuar edhe është ky buxhet që është, por sidoqoftë me gëzon fakti se të hyrat janë të mira edhe uroj që të vazhdoj kështu. Unë do te ndalem te faqe 8, shpenzimet buxhetore sipas kategorive ekonomike konkretisht tek pagat dhe mëditjet, kërkoj nga drejtori një sqarim pak më të hollësishëm. Po ashtu po shohim se shpenzimet janë bërë mbi normën e planifikimit dhe në bazë të një llogaritje që e kam bërë unë atëherë janë shpenzuar mbi 97,000 euro më shumë se që është planifikuar, kur është fjala për kategorinë paga dhe mëditje kur e dimë se kjo kategori është fikse dhe është planifikuar ashtu siç është dashur edhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar 2020 janë shpenzuar mbi 156,000 euro më shumë për paga dhe mëditje, pra edhe këtu kërkojmë sqarim për këtë. Kur është shpenzimi për kategori tjera kapitale, mallra dhe shërbime është krejt në rregull dhe do t'i gëzoheshim pastaj, mirëpo në paga dhe mëditje është pjesë e ndjeshme sepse mendoj se në këtë kategori duhet të ketë më pak shpenzime e jo më shumë. Pra, sukcesi i qeverisë lokale është nëse ka më pak shpenzime në këtë pozicion në mënyrë që të mbeten të hollat për projekte tjera për qytetarët kurse këtu kemi të kundërtën. Gjithashtu kam vërejtje se këto shpenzime i keni më shume në shëndetësi dhe arsim, kështu që nëse doni ju tregoj edhe në shifra, në shëndetësi, për paga vetëm ne 3 mujorin e parë për këtë vit janë shpenzuar mbi 72,000 euro, në arsim mbi 73,000 euro, pra këto dy drejtori kanë shpenzuar më shumë në paga dhe mëditje dhe për këtë duam sqarim rreth këtyre shpenzimeve se pse kanë ndodhur këto.

Ali Zhuniqi – Tek kodi 13131 mëditjet e udhëtimeve zyrtare brenda vitit, e shohim që brenda 3 muajve vetëm arsimi ka shpenzuar 6382,78 cent, kështu që në logjikën e para llogaritjes është një shumë e madhe për një periudhë 3 mujore, pra kisha kërkuar sqarim në raport me këtë.

Afrim Limani – Faleminderit për pyetjet, unë do fillojë me radhë që nga kryesuesi që kërkoj sqarim lidhur me dy kategoritë e shpenzimeve të buxhetit në mirëmbajtjen e ndërtesave dhe dreka zyrtare. I nderuari kryesues, edhe në mbledhjen e KPF-së ju kam dhënë një sqarim mirëpo edhe kësaj radhe do e paraqes para kuvendareve. Te drekat zyrtare ky shpenzim i buxhetit kemi pasur një obligim nga viti 2020 rreth një fature nga shoqata „Egzodi 99,“ që është një vendim që e ka marr Kuvendi në vitin 2014, ku kam qenë edhe unë pjesë e asaj legjislatore dhe këto shpenzime janë kryesisht për atë faturë për dreka zyrtare sepse kuvendi e ka nxjerrë ekskluzivisht për këtë shpenzim. Nuk e di a kam të drejtë rreth kësaj mirëpo edhe vitin e kaluar kam kërkuar nga ju që nuk më takon mua por kisha propozuar që me shfuqizua këtë vendim edhe me nxjerr një vendim të ri, nuk jam kundër që mos me i ndihmua shoqatës mirëpo dedikimi i mjeteve të shkon për një qëllim të caktuar në një aktivitet tjetër dhe jo për dreka zyrtare. Ndërsa pjesa tjetër e shpenzimit të buxhetit për mirëmbajtjen e ndërtesave, që ne e kemi një kompani të kontraktuar që bën mirëmbajtjen e objekteve të komunës ku pjesë është edhe kjo sallë e kuvendit pasi ka pasur mjete të lira edhe i kemi shpenzuar atë sasi dhe konsideroj që mjetet janë shkuar në destinim të caktuar. Florida Bajraktari kërkon sqarim rreth taksave që janë kryesisht në urbanizëm kështu që nëse ju kujtohet taksa komunale për legalizim, taksa komunale për leje ndërtimi dhe inspektimi i planit urbanistik nga viti i kaluar kemi pasur një problem sepse të hyrat kanë qenë të inkasuar anasjelltas, pasi që ne vend që të hyrat komunale për leje ndërtimi të inkasohen në vend ato janë inkasua në

planin urbanistik dhe pikërisht për këtë planifikim nuk ka edhe realizim realisht nuk këtu. Ndërsa taksa komunale për leje ndërtimi i kemi te planifikuara 20,000 euro dhe realisht janë inkasuar 7956 dhe shpresoj që deri në 3 mujoret e fundit të arrij shumën maksimale të planifikimit, pra ky është dallimi. Ndërsa taksa komunale për legalizim është e hyrë e planifikuar që vitin e kaluar ka ecur shumë mirë mirëpo sivjet po stagnon sepse nuk ka interesim të qytetarëve të aplikojnë për legalizim. Pastaj shpenzimi i buxhetit i vogël, për mendimin tim konsideroj nëse marrim përqindjen në raport me 3 mujorin që kemi, besoj që është një shpenzim mesatar mirëpo zakonisht buxheti shpenzohet me shumë më tepër në 3 mujorin e fundit të vitit para mbylljes së vitit fiskal. Pastaj Masar Popaj i ngriti disa pyetje, e ngriti një problem që shpërndarja e faturave të tatimit në pronë nuk shkon në adresën e duhur, realisht është pyetje me vend dhe pajtohemi për këtë mirëpo shpresoj që në këtë vit nuk do të përsëritet sepse kam pasur takime me përfaqësuesin e postës edhe kam marrë zotime që punëtori i tyre që punëtori i tyre faturën të dërgojnë në adresën e caktuar dhe jo me i lanë nëpër shkollë apo shitore. Pastaj pyetje tjetër ishte rreth shpenzimit të buxhetit të mëditjes e udhëtimit brenda vendit, që realisht të njëjtën pyetje e bëri edhe Ali Zhuniqi. Këto janë shpenzime kryesisht që emërtohen në këtë kod të mëditjes që janë shpenzimet të cilat kompanitë e kontraktuara i bartin nxënësit d.m.th. ky kod është të bartja e nxënësve. Në kemi disa kompani të kontraktuara që bartin nxënësit, që një pjesë e konsiderueshme janë nga Kramoviku, pastaj nga pjesa e Retisë, nga Zatriqi edhe nga vende tjera. Këto shpenzime janë të emërtuara të ky kod që ndërlidhet krejt të shpenzimet e bartjes së udhëtarëve. Doktor ju falënderoj për fjalët e mira që i the, pasi një ndryshim të mirë dhe pozitiv në rritjen e të hyrave raport me vitin e kaluar, mirëpo ajo që juve ju interesoj me shumë është shpenzimi i buxhetit brenda kësaj periudhe është më i madh se pretendohet dhe në të njëjtën pyetje e keni bërë edhe në KPF. Kështu që unë konsideroj që buxheti për këtë periudhë është i arsyeshëm ndoshta është pak më i gjerë sepse në këtë shpenzim janë përfshirë edhe mëditjet të cilët i kanë marrë punëtorët shëndetësorë edhe punëtorët e arsimit nga vendimi i qeverisë rreth pagesave shtesë të mëditjeve për punëtorët shëndetësorë dhe të arsimit edhe për këtë është dallimi, sepse nëse bëjmë një krahasim buxheti i planifikuar për kategorinë e pagave është 7,622,634 euro dhe nëse i përpjesëtojmë për 12 muaj atëherë mesatarja del 635,219 euro. Ndërsa këtu një mesatare për 3 muaj i kemi 667,507 edhe ky ndryshim i vogël është pikërisht për ato mëditje që i potencova, pra kjo i përfshin të gjitha kategoritë si punëtorët e arsimit, punëtorët e shëndetësisë edhe kuptohet punëtorët e administratës. Kështu që besoj që ju dhashë përgjigjet dhe gjithashtu faleminderit për pyetjet.

Fehmi Cena – E falënderoj drejtorin që u mundua me sqarua për të gjitha pyetjet e bëra mirëpo te kjo që unë pyeta të shpenzimet në paga dhe mëditje nuk jeni shumë bindës, pasi që ju thatë se janë shtesat në shëndetësi që merren për shkak të pandemisë dhe unë e di se shtesat e shëndetësisë për shkak të pandemisë janë nga granti qeveritar pikërisht nga pakojat për rimëkëmbje dhe ato janë të ndara nga qeveria ashtu e dimë ne. Kështu që është dashtë me u bërë planifikimi dhe këtë nuk e keni bërë dhe një buxhet ka kaluar këtu kështu që mund të jetë ajo por mund të jetë edhe diçka tjetër. Atëherë, në kërkojmë raportin saktësisht se për çka është shpenzuar, pasi në Komitetin për Politikë dhe Financa e keni shpjeguar se Caritas apo Kosova Med e ka marrë por nuk është ajo sepse ajo është e paraparë me një pozicion tjetër, kështu që ju do të na jepni sqarimin ashtu siç po thoni ju pasi në nuk e kemi ditë. Në arsim, arsimit fillor i ka shpenzuar mbi 73,000 më tepër nëse është fjala për 3 muaj dhe kur të kalojnë edhe 3 muaj tjerë atëherë do të vjen raporti 6 mujor dhe do të bëhet edhe më shumë dhe kështu do të kërkonin rishqyrtimin e buxhetit dhe gjithashtu do të kërkonin leje prej neve që ne me aprovua ndryshimin buxhetor, por, arsyeja duhet me qenë bindëse, pasi mua me intereson edhe në arsim pse janë shpenzuar mbi 73,000 më tepër, pse nuk janë planifikuar këto, për çka janë shpenzuar këto, a kanë mëditje shtesë apo kanë punësuar punëtorë pasi ka vërejtje nga qytetarët rreth punësimeve në arsim për shumë arsye dhe nuk po futem në detaje pasi njëherë tjetër sigurisht se do ta diskutojmë atë, por sqarimi duhet të jetë sepse janë goxha para më shumë që janë shpenzuar në këtë kategori.

Afrim Limani – Në mbledhjen e KPF-së, u sqaruam në një pikë pasi edhe punëtorët e Caritas-it janë paguar sipas vendimit të qeverisë nga 100 euro, prej këtij pozicioni të pagave, pasi që punëtorët e Caritasit paguhën nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve mirëpo janë paguar nga pozicioni i pagave nga vendimi i qeverisë që i marrin në pjesën prej 100 euro. Shpenzimi i buxhetit në kategorinë për paga është shumë i sakt, pra 2,273,000 euro, kurse buxheti i planifikuar i komunës së Rahovecit për vitin 2021 në total është 7,622,634 euro, kur e përpjesëtojmë për 12 muaj atëherë kjo i bien që 635,219 euro për muaj edhe sigurisht se në fund ta jep shumën e saktë pa asnjë dilemë. I kemi shpenzuar 2,200,703 dhe nëse i përpjesëtojmë për 3 muaj atëherë na del që muaji është 667,567 që ka një ndryshim të vogël me të madhe në krahasim me përpjesëtimin me 12 muaj. Arsyeja që një pjesë është me të madhe është sepse i kemi paguar nga pozicioni i pagave tona i kemi paguar punëtorët shëndetësor dhe të arsimit. Kështu që nëse i referohemi faqes 7 shpenzimi i buxhetit sipas kategorive, atëherë ne e kemi shumë të qartë pasi pozicioni i pagave dhe mëditjeve që total i bien mbi 2 milion, zyra e kryetarit i ka të shpenzuara 41,343 euro që do të thotë administrata 49,622 euro pra i kemi të pasqyruara të gjitha. Arsimi fillor i ka 1,087,167 euro sepse arsimi fillor ka pjesën me të madhe të mësimdhënësve dhe pikërisht edhe shpenzimi është me të madhe. Ky buxheti i joni i planifikuar, në nuk guxojmë me mbete pa këtë buxheti dhe nëse na marrin jashtë këtij atëherë në një 3 muaj tjetër mundën me i rikthye prapë sepse ky buxheti i planifikuar me vendim të kuvendit është i mbrojtur edhe me ligjin e financave publike dhe përgjegjësi.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për të gjitha sqarimet, kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për bartjen e rezervave të investimeve kapitale të vitit 2021.

Afrim Limani – Të nderuar asamblistë, në vitin 2020 ministria e Financave ka nxjerrë një udhëzim administrativ që kërkon që të gjitha projektet kapitale të cilat futen në sistemin Pip (programi i investimeve publike) të i nënshtrohen një kriteri, pra kriteret të cilat ata i vlerësojnë se a kalojnë apo jo. Fatkeqësisht në komunën tonë janë disa projekte që nuk kanë kaluar si rezultat i atij udhëzimi dhe i atyre kriterëve që i ke përcaktua ministria e financave. Pra, shumica e mjeteve që nuk kanë kaluar në total është 265,000 euro, pra 85,000 janë prej të hyrave vetanake dhe pjesa tjetër nga granti. Kështu që në pas konsultimeve të shumta që i kemi pasur me departamentin e buxhetit të Ministrisë së Financave na ka lejuar që edhe njëherë vlera e projekteve që nuk kanë kaluar, pra tash duhet me qenë vetëm projekte të reja, jo ato ekzistuese që mundën me qitë edhe të reja. Atëherë ne kemi bërë një analizë të thellësishtë të projekteve që tash do të propozohen të kalojnë, pasi për ndryshe nëse nuk kalojnë atëherë këto rezerva mundën me shkua edhe në suficite. Ne i kemi paraparë 3 projekte, një është në shëndetësi, një në shërbime publike dhe një në urbanizëm. Këtu i kemi të shkruara se cilat projekte edhe këto një pjesë janë të ndara nga granti dhe një pjesë nga të hyrat vetanake. Kur është fjala të projekti, ndërtimi i kanalit për ujëra atmosferik dhe ndërtimi më kubëza betoni në fshatin Zatriq, prej grantit i kemi shumën prej 34,000 ndërsa të hyra vetanake i kemi 20,000. Projekti i shtratit të përroit në lagjen Kelmendi në Kramovik në vlerë prej 71,000 euro pra 6000 nga granti dhe 65,000 nga të hyrat vetanake dhe projekti tjetër është në shëndetësi që realisht ky projekt ka qenë edhe atëherë edhe nuk ka kaluar mirëpo i kemi marr rekomandimet e nevojshme edhe besoj që ky projekt do të kalon tani sepse e dimë se çka duhet me veprua tash, kështu që edhe ky projekt është si propozim vendim me kalua pasi i kemi ndarë 140,000 euro pra kemi ndaje me shumë mjete pasi e dini se drejtorja e shëndetësisë e dini të gjithë e ka grantin specifik të buxhetit që në nuk mund të marrim nga ajo por vetëm i japim por fatbardhësisht kësaj here, drejtorja e shëndetësisë këtë vit ka një buxheti me të mirë atëherë e kemi ndaje edhe këtë shumë. Të nderuar asamblistë, kërkoj nga ju që ta votoni këtë pikë të rendit të ditës sepse janë në pyetje 265,000 euro të cilët nuk votohen edhe kësaj here me siguri që shkojnë në suficite.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për sqarimet, do te ishte mirë që me kalua pasi edhe ashtu ne po kemi pak mjete dhe nuk do te ishte mirë me lejua që edhe këto pak mjete të na shkojnë në suficit.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, edhe në KPF e kemi shqyrtuar këtë pikë të rendit të ditës edhe shumë normale që këto projekte nuk janë pranuar për arsyet e veta sipas specifikave të veta që nuk i kanë plotësuar kushtet sikur projektet tjera që kanë qenë. Pra, është mirë edhe interes për komunën e Rahovecit dhe për qytetarët e komunës së Rahovecit që të mos shkojnë në suficit por të shfrytëzohen për projektet të cilat i kanë paraqitur këtu. Kështu që unë e mbështes këtë bartje të këtyre mjeteve për investime kapitale.

Munib Durguti – Faleminderit shumë kryesues, atëherë drejtori e dha sqarimin për bartjen e këtyre mjeteve ne projekte ashtu siç i ka ndarë në projeksion, por mua më intereson një çështje edhe pse nuk e kemi drejtorin e shëndetësisë për bartjen e mjeteve ne projektin Renovimi i objektit të vjetër të QKMF-së, a kemi kontratë këtu apo po synohet që me këto mjete të shpallet tenderi dhe fillohet tutje me procedurë, pasi që vitin e kaluar ka qenë e planifikuar si projekt. Po dua të di si informatë që a kemi punime aty dhe po dëshirojmë me i bart këto mjete apo po fillojmë prej fillimi.

Rukije Krasniqi – Faleminderit kryesues, shumë e bartjes që ekziston pothuajse 70% po e merr shëndetësia. Kështu që në shëndetësi më së shumti po investohet pothuajse në të gjitha mandatet që investohet në shëndetësi si në renovime ashtu edhe në ndërtime. Mendoj që për këto bartje pse mos me ja kalua arsimit ku frekuentojnë një numër i madh i nxënësve, rregullimin e infrastrukturës, përmirësimin e gjendjes në arsim e sidomos në shkolla dhe është shumë e nevojshme edhe në QKMF, me të vërtetë investohet shumë shpesh. Gjithashtu mendoj që kryetari e tha më herët se kemi borxhe dhe kemi projekte atëherë pse mos me i alokua për borxhe si shembull konkret padia e mësimdhënësve për pagesën e rrogave jubilarë nga mjetet që ekzistojnë. Pastaj, investimet e mëtutjeshme të projekteve të ndryshme që janë në mungesë, nuk kisha me thënë për shujta se është një shumë e madhe por e gjithë kjo bartje për renovimin e QKMF-së, mendoj se nuk është e nevojshme pasi që në mbledhjen e kaluar vet drejtori i shëndetësisë nuk ishte ne gjendje me e mbrojt propozimin e vet dhe ndryshoj në momentin e fundit sa që qiti në lajthitje edhe kam votuar kundër, kështu që unë këtë nuk e votoj këtë propozim të drejtorit.

Sali Sallteku – Me pëlqen diskutimi i Rukijes edhe pajtohem me mendimin e saj edhe jam kundër propozimit që e dha shefi i grupit tonë sepse nuk mendoj se duhet me i bart këto mjete, kështu ashtu siç po thotë Rukija të mbesin ashtu.

Shqipe Kryeziu – Faleminderit kryesues, edhe unë e mbështesë zonjën Rukije dhe vërtetë është ide e mrekullueshme, është mendim i mirë dhe moment i duhur për kërkesat e mësimdhënësve, nuk është që po kërkojmë në mënyrë individuale, për ndonjë kabinet por vetëm investimet me qenë ne arsim, pasi edhe ashtu komuna jonë ne arsim nuk qëndron mirë sepse dje është mbajtur testi PISA as edhe kompjuterë nuk ka pasur, kështu që nuk e di edhe si e kanë mbajtur atë test. Pra, ka nevojë që këto investime me u bart në arsim.

Afrim Limani – I nderuari Munib, në mungesë te drejtorit do te mundohem me te dhanë përgjigje për aq sa kam informata. Realisht ky është projekt i ri parashihet që te bëhet renovimi i repartit, sektorit te pediatriisë, pasi herën e parë nuk ka kaluar ky projekt edhe vlera e buxhetit ka qenë 140,000 euro d.m.th. është projekt i ri ne kuadër te objektit te vjetër pasi nuk ka pasur mjete te alokuara dhe tash i kemi ne dispozicion 140,000 euro dhe po konsideroj se është shume konsiderueshme me fillua edhe me operua ne kuadër te atij projekti. Pastaj Rukije Krasniqi i ngriti disa shqetësime se pse ky buxhete po kalon ne shëndetësi e jo ne arsim apo dikun tjetër. Siç e thash edhe me herët buxheti i shëndetësisë dhe arsimit janë grante specifike, pasi aty ku janë edhe duhet me u shpenzua. Komuna mundet me dhanë mjete edhe shëndetësisë edhe arsimit mirëpo shëndetësia nuk ka te drejt askujt me i dhanë me i shfrytëzua mirëpo vetëm për vete. Kështu që e mira kësaj është se vitet e kaluara kemi pasur gjithmonë deficite apo mungesë te buxhetit ne shëndetësi dhe gjithmonë e kemi mbuluar pjesën tone nga granti, kështu që edhe kësaj here i ka paret e veta edhe investon. Me herët që

ngritët çështjen e arsimit, sigurisht se pajtohem mirëpo ky është buxhete nga investimet kapitale edhe janë mjete që duhet te shpenzohen ne projekte te reja ne investime kapitale e jo në një kategori tjetër. Kurse sa i përket investimeve kapitale po ju jap informatën disa i takojnë shkollave buxhete për investime sipas formulës, kështu që për vitin 2022 i kanë 65,000 euro kurse i kanë pasur 9000 euro. Mirëpo komuna që ka të drejtë i ka dhënë pare arsimit edhe vlera e projekteve kapitale ne arsim ka qenë vlera e buxhetit 600,000, që d.m.th. se për 3 vite i kemi ndaje nga 600,000 për investime kapitale ne arsim sepse i kemi 3 projekte madhore, ne fakt 6 projekte madhore që fatbardhësisht shumica prej tyre po kryhen pra 3 shkolla dhe 3 çerdhe, që realisht e shpenzojnë një pjesë te madhe te buxhetit. Pra kjo përgjigje e imja vlen edhe për Shqipen edhe për Saliun.

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor për sqarimet, te nderuar kolegë kuvendarë e qesim ne votim pikën e katërt e rendit te ditës. Konstatojmë se me një votë kundër dhe një abstenim aprovohet pika e katërt e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e pestë te rendit te ditës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës se paluajtshme në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P – 05864-0 Rahovec.

Afrim Oruqi – Të nderuar anëtarë te kuvendit, para jush keni propozim vendimin e kryetarit te komunës për dhënien ne shfrytëzim afatshkurtër prej 1-15 vite te pronës komunale e cila gjendet ne zonën kadastrale ne Rahovec, ne vendin e quajtur Perzhina me numër 05864-0 me sipërfaqe prej 20 ari 31m2. Qëllimi i dhënies se kësaj prone me qera është ruajtja dhe rritja e vlerës, zhvillimi dhe kultivimi i bujqësisë, blegtorisë si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve që te vetëpunësohen dhe propozoj që këtë pronë te japim me qira për 15 vite. Kjo pronë saktësisht gjendet te hyrja te mulliri Vetoni dhe asaj zone kadastrale i thojnë Perzhina dhe kjo rruge del te ura e Files apo ku është materiali ndërtimor i biznesit Kondor. Pra është tokë e papunuar djerrinë dhe tokë e komunës, kështu që kërkoje nga ju që pas shqyrtimit të aprovon propozimin për dhënien me qira të kësaj prone.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, e dëgjuam drejtorin me vëmendje mirëpo unë desha diçka me propozua pasi që i kemi 4 propozime dhe 4 vendime, atëherë do të ishte mirë që të gjitha me i qitë në pako edhe t'i votojmë menjëherë pasi e njëjta gjë është për të gjitha. Pra, propozoj që të gjitha me i futë në pako kurse vendimet të bëhen veç e veç.

Fehmi Cena – Edhe ne mendojmë njëjtë pasi këto 4 pika faktikisht e kanë qëllimin e njëjtë edhe kanë destinime të njëjta, bile dua edhe të falënderoj drejtorin sepse e ka dhënë sqarimin që kemi kërkuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe sigurisht të shkruhet edhe destinimi herave tjera, pra, është e qartë se këto prona do të shërbejnë për bujqësi dhe blegtori, pasi edhe janë toka pjellore bujqësore, vetëm se tek propozimi juaj që e keni dhënë në KPF ka qenë 15 vite në shfrytëzim kurse këtu nuk ka pasi është rubrika e zbrazët dhe këtu ne mund të japim mendimin, kështu që veç e mora fjalën mendoj që për 10 vite do të ishte më e arsyeshme me dhënë në shfrytëzim e pastaj më tutje do të shohim.

Munib Durguti – Nëse ka mundësi drejtori edhe një sqarim të vogël, që mos keni informatë ne lidhje me prona, mos kemi procese të hapura gjyqësore prej palëve që mos ka pretendime pasi është shumë e nevojshme që edhe kjo informatë t'i bartet kuvendit në mënyrë që vendimmarrja të jetë pa dilema.

Afrim Oruqi – Po është pyetje me vend, për se cilën padi që i vjen komunës se Rahovecit i drejtohet avokatit te komunës dhe avokati prej fazës se parë kërkon prej drejtorit te gjeodezisë dhe kadastrës dhe pronë te siguroj materiale dokumente historiate të parcelave. Këto parcela nuk janë në kontest gjyqësor deri sot.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për sqarimet, atëherë në bazë të propozimit të z. Fazliu shkojnë në pako mirëpo për shkak të procedurës një nga një i qesim në votim dhe gjithsesi duhet theksuar dhënia në shfrytëzim për 10 vite.

Atëherë e qesim në votim pikën e pestë të rendit të ditës. Konstatohet se me një votë abstenim aprovohet pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozimit të Kryetarit për miratimin e vendimit paraparak për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P – 07111-1 Rahovec.

Të nderuar kolegë kuvendarë, e qesim në votim pikën e gjashtë të rendit të ditës. Atëherë konstatohet se me një votë abstenim, aprovohet pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozimit të Kryetarit për miratimin e vendimit paraparak për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P – 02352-0 Rahovec.

Të nderuar kolegë kuvendarë, e qesim në votim pikën e shtatë të rendit të ditës. Konstatohet se me një votë abstenim, aprovohet pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozimit të Kryetarit për miratimin e vendimit paraparak për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P – 00251-0 Çifllak.

Të nderuar kolegë kuvendarë, e qesim në votim pikën e tetë të rendit të ditës. Konstatohet se me një votë abstenim, aprovohet pika e tetë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozimit të Kryetarit për vënien në debat publik të Draft strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal për komunën e Rahovecit 2021-2025.

Të nderuar kolegë, është pikë e cila duhet të merr aprovimin vetëm për dalje në debat publik, atëherë vetëm e qesim në votim. Kështu që e qesim në votim pikën e nëntë të rendit të ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e nëntë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit të Auditimit për vitin 2020.

Sead Boshnjaku – Përsëritet kryesues dhe ju kuvendarë. Shpresoj që e keni të gjithë raportin e punës së Komitetit të Auditimit. Në vitin 2020 ne si Komitet i Auditimit të Brendshëm, kemi mbajtur gjithsej 4 takime. Unë si anëtar i komitetit në emër të kryesuesit të Komitetit të Auditimit z. Sead Rama do të mundohem t'i shtjelloj të gjitha një nga një apo veç i keni dhe veçse i keni të gjitha në material.

Kryesuesi – Ne e kemi marr materialin e raportit vjetor të punës së Komitetit të Auditimit dhe gjithsesi i kemi edhe ne shqetësimet dhe kërkesat tona për informacionet më të detajuara sa i përket raportit të auditimit.

Rasim Fazliu – E falënderoj zyrtarin që raportoj për raportin vjetor të punës së Komitetit të Auditimit. Unë desha të flas diçka në mënyrë të veçantë, pasi e kam lexuar me vëmendje dhe e kam analizuar por ajo çka mua më intereson është që Komiteti i Auditimit, mirë që i ka mbajtur këto takime mirëpo ka pak të dhëna rreth raportit të auditimit të brendshëm, i cili asnjëherë nuk na vjen në kuvend mirëpo kryesore ne me ditë se si po shkojnë zhvillimet në komunën e Rahovecit në përgjithësi. Kështu që këta kanë mbajtur mbledhje, gjithsej 4 mbledhje duke i përcjellë edhe punën e drejtorive, por, siç shihet ka pak material rreth kësaj çështje, por unë fjalën e mora për diçka tjetër. Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe sigurisht se komitetin e falënderoj për punën e kryer pasi që kjo gjithmonë ka qenë një e gjetur tek Auditori i Jashtëm. Përpara kur nuk kemi pasur Komitet të Auditimit gjithmonë e kemi pasur vërejtje se nuk ka Komitet të Auditimit kështu që tash është mirë që e kemi. Por, për Njësinë e Auditimit të Brendshëm, për mua, është e pakuptimtë nëse bëhet auditimi i përgjithshëm apo gjeneral dhe më pastaj njësi jonë, që është e auditimit të brendshëm fillon me u marr me ato çështje prapë, kur e dimë se auditimi i brendshëm luan rol këshillëdhënës që mos me lejua ekzekutivin gjegjësisht komunën me bo gabime apo lëshime që me pengua që mos me pas të gjetura nga ana e auditimit të jashtëm. Prandaj, në këtë drejtim ndoshta ne muajt e parë të vitit nuk kanë edhe çka me gjet janar, shkurt, mars, prill, dhe ky është një defekt që po na përcjellët vazhdimisht pastaj disa të gjetura që janë po na përsëriten vazhdimisht prej viti në vit dhe do të ishte mirë që në këtë drejtim Komiteti i Auditimit të Brendshëm me i harmonizua çështjet dhe me i këqyr mirë dhe bashkë me Njësinë e Auditimit të Brendshëm edhe për çdo vit me pas sa më pak të gjetura me pas Auditori i Jashtëm.

Ali Zhuniqi – Ky raport i punës me shumë i ngjason një procesverballi se sa një raporti të punës, pasi në përmbajtje nuk ka absolutisht atë që përmban titulli dhe nuk ka bazë përmbajtjesore hiq. Pra, më tepër e vërteton se të gjeturat e Zyrës së Prokurimit dhe më pastaj konkluzionet. Kështu që kur ka të gjetura, nuk mundesh që të gjeturat e Zyrës së Prokurimit me përmbledh me katër rreshta dhe në fund me dhanë një konkluzion. Kështu që, ka shumë probleme dhe nuk e konsideroj si raport por si procesverbal që në kuadër të këtij komiteti që këta i kanë mbajtur mbledhjet dhe i kanë dhënë mendimet e tyre duke u bazuar në raportet, me raportet që i kanë parë mirëpo në përmbajtje nuk është.

Sali Sallteku – Unë mendoj se kjo nuk ka kurrfarë karakteri dhe nuk votohet kështu që kjo është më shumë se një informatë dhe nuk kemi nevojë edhe të diskutojmë më shumë rreth kësaj, pasi që nuk kemi çasje kurrgjë këtu.

Kryesuesi – Faleminderit z. Sallteku, gjithsesi pjesa e informatave, raporteve do të ishte mirë që ne të informohemi rreth pjesës së punës aty. Të nderuar kolegë kuvendarë, ju falënderoj të gjithëve për kontributin tuaj dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

KRYESUESI

Afrim Dina



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO



KUVENDI KOMUNAL / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY RAHOVEC


KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Odeljenje za Zdravstvo i Socijalno Osiguranje

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Odeljenje za Zdravstvo i Socijalnu Zastitu
Department of Health and Social Welfare

-VI- Nr. I prot 107 Më 21.05 2021
Br. prot. 107

RAHOVEC - ORAHOVAC

Datë/Datum/Date:	21.05.2021
Referenc-ë	
CC	
Për/Za/To:	Sekretarinë e Kuvendit- Rahovec
Nga/Od/From:	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Rahovec
Subjekti/Predmet/Subject:	Informatë rreth Pandemisë Covid-19 DSHPS



DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, gjatë kësaj periudhe raportuese ka zhvilluar aktivitetet e saj në të gjitha fushat e veprimtarisë, me qëllim të rritjes së cilësisë të shërbimeve të Kujdesit Parësor Shëndetësor si dhe ngritjes së përgjithshme të cilësisë së jetës së qytetarëve të komunës, përfshirë këtu edhe mbështetjen në fushat e shërbimeve sociale dhe më gjerë.

Nga muaji mars 2020, që është karakterizuar me një sërë aktivitete dhe masash të ndërmarra nga Komuna e Rahovecit për Covid-19, si drejtori në funksion të mbrojtjes së shëndetit publik të popullatës dhe menaxhimit të situatës nga përhapja e Covid-19, kemi ngritur në nivel të lartë gatishmërinë për t'u ballafaquar me raste eventuale të këtij virusi, duke ndërmarr masat e nevojshme për parandalimin e infeksionit nga Virusi Korona COVID-19. Si drejtori e shëndetësisë i kemi zbatuar të gjitha rekomandimet e dala nga IKSHPK-ja, ku edhe gjatë inspektimit nga Ministria e Shëndetësisë, përkatësisht inspektorët shëndetësor QKMF-ja në zbatimin e rekomandimeve është vlerësuar maksimalisht.

Deri në këto momente kur po raportojmë kemi gjithsej 1173 raste me Covid-19, raste aktive janë 26, të shëruar janë 1076 dhe me fatalitet janë 71.

Kemi pranuar 1832 doza të vaksinave Astrazeneca, dhe 192 PFIZER (Fajzer) ku fillimisht është vaksinuar stafi shëndetësor, ndër të cilët një pjesë kanë hezitur të vaksinohen, pastaj ka vazhduar vaksinimi i të moshuarve mbi 85 vjeç, si dhe të sëmurët kronik, duke zbatuar rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë rreth vaksinimit të popullatës kundër virusit Covid-19.

Deri më tani janë vaksinuar 1596 qytetar me Astrazeneca, dhe 192 me Pfizer (Fajzer), ndërsa janë rezervë 400 doza me rekomandim të MSh, për vaksinim të qytetarëve me dozën e dytë.

Po ashtu në QKMF, po bëhen teste rapide për Covid-19 dhe nga fillimi i testeve deri më tani janë kryer 1122 teste rapide, 118 kanë rezultuar pozitiv me Covid-19, ku këto të dhëna janë regjistruar edhe në IKSHPK, në raportin ditor të cilin e bën QKMF-ja çdo ditë.

Në mënyrë që të ofrojmë shërbime profesionale dhe të sigurta për qytetarët, është marrë vendim që në të dy QMF-të në Krushë të Madhe dhe Ratkoc edhe ditën e shtunë të punohet me orar të rregullt.

Në njërën nga mbledhjet e mbajtura të Kuvendit Komunal më 2020 është miratuar propozim-vendimi i Kryetarit, z. Smajl Latifi për miratimin e mjeteve financiare në vlerë prej 10.000 euro për menaxhimin e situatës së krijuar nga virusi COVID-19

Vazhdon dezinfektimi i objekteve shëndetësore ku çdo vikend dezinfektohen të gjitha institucionet shëndetësore dhe deri në këto momente kur po raportojmë janë dezinfektuar 60 herë, si QKMF, QMF, AMF, ndërsa reparti I Mjekësisë Familjare dhe Emergjenca dezinfektohen çdo ditë pune.

Kemi bërë dezinfektimin e të gjitha objekteve dhe institucioneve publike, duke përfshirë të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit, si: objektet shëndetësore (QKMF, QMF-të, AMF-të), objektet e administratës komunale, objektet fetare: (Xhamitë dhe Teqetë), Stacioni i Autobusëve, Stacioni Policor, objekte kulturore dhe sportive etj.

LISTA E OBJEKTEVE TË DEZINFEKTUARA NË KOMUNËN E RAHOVECIT

QKMF, QMF-të, AMF-të	60 - objekte shëndetësore	Komuna Rahovec
Objekte fetare	24 -xhami në tërë Komunën e Rahovecit	Komuna Rahovec
Objekte fetare	2 -teqetë në Rahovec	Komuna Rahovec
Objekte kulturore dhe sportive	Palestra Sportive, shtëpitë e kulturës	Komuna Rahovec
Objekti i pasaportave	5 – Kompetencë e MPB	Komuna Rahovec
Stacioni i autobusëve	5-Stacioni i autobusëve në Rahovec	Komuna Rahovec
Stacionet Policore	2- Stacioni policor në Rahovec dhe nënstacioni Policor në Zoqisht	Komuna Rahovec
Objektet e Komunës së Rahovecit	20- Objektet e administratës komunale në Rahovec, të dezinfektuara në tërësi. Salla e kuvendit dezinfektohet çdo herë nje ditë më herët para seancës së kuvendit dhe të KPF-së.	Komuna Rahovec
Institucione të drejtësisë	2 Objekti i Gjykatës Themelore Gjakovë- dega në Rahovec	Komuna Rahovec
Institucione arsimore	4 Çerdhja "Tulipanët" në Rahovec	Komuna Rahovec
Spektori privat	3 Kompanitë private që kanë një numër të konsiderueshëm të punëtorëve	Komuna Rahovec

Komuna e Rahovecit, përkatësisht DSHPS-ja, ka planin operativ duke caktuar edhe vendin për ngritjen e një karantine e cila në rast nevojë, do të përdoret me qëllim të menaxhimit të rasteve të ekspozuara ndaj virusit, sipas nevojës, ky plan zbatohet në rast përkeqësimi të gjendjes me Covid-19. Pas situatës së krijuar nga rreziku i infeksionit COVID-19, të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë, individë e biznese, po vazhdojnë, traditën, humanizmin dhe solidaritetin, në mbështetje të qytetarëve, duke dhuruar kështu donacione të ndryshme si: pako ushqimore dhe higjienike, destilatë, dezinfektues për duar, ndihmë në vlerë monetare etj.

Shpërndarja e pakove ushqimore dhe higjienike është bërë në përputhje me listat e përpiluara në bashkëpunim me kryetarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane në qytetin e Rahovecit, Qendrën për Punë Sociale në Rahovec dhe Kryqin e Kuq.

Si drejtori vazhdimisht jemi ballafaquar me mungesë të materialit mbrojtës për personelin mjekësor si maskat mbrojtëse, dorëzat, dezinfektues, rroba mbrojtëse dhe syza mbrojtëse për personelin shëndetësor që janë vija e parë e frontit me COVID-19, ndërsa tani në këto momente furnizimi me material mbrojtës është stabil dhe i qëndrueshëm, por, në vazhdimësi jemi ballafaquar me mungesën e barnave nga lista esenciale dhe në këto momente që po raportojmë kemi nënshkruar kontratën për furnizim me barna emergjente për nevojat e QKMF-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

INFORMATË NGA DBPZHR

Janar- Maj 2021



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Odseljenje za Poljoprivredu Šumarstvo i Rurl. Razvoj



-XI- Nr. i prot. 185 Më 20.05.2021
Br. prot. 185 Dt. 20.05.2021
RAHOVEC - ORAHOVAC



PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	2
DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL	3
Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars, prill, maj.....	3
Dëmet e shkaktuara nga fatkeqësit natyrore gjatë muajit Janar 2021.....	3
Aplikimi për litër qumësht.....	4
Shpërndarja e mekanizmave bujqësorë.....	5
Dhënia e pronave të paluajtshme në afatshkurtër.....	5
Aplikimi për Pagesa e Direkte – Subvencione për vitin 2021	5
Skema e granteve në MBPZHR	6
Vaksinimi i bagëtive dhe qenëve shtëpiak	7
Projektet e investimeve kapitale	8
“ Ndertimi i serrave me participimin 80%-20%”	8
Ndërtimi i stallave për fermerët blegtorë	9
Sfidat e DBPZHR-së	10
PËRFUNDIM.....	10

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Komuna e Rahovecit përmes politikave dhe strategjive zhvillimore është orientuar në mbështetje të faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm zhvillimor. Këto politika dhe strategji janë duke krijuar mundësi që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë më efikas i resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural janë sektorët kryesor të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Fillimi i vitit është karakterizuar me përpilimin e planit të punës për vitin 2021, plani i hartuar është mjaft ambicioz i cili ka ngërthyer në vehte aktivitete të shumta në kuadër të drejtorisë së bujqësisë. Në kuadër të këtij plani është bërë edhe planifikimi i aktiviteteve.

Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars, prill, maj.

Drejtoria për BPZHR, për vitin 2021 ka paraparë rritjen e kapaciteteve prodhuese, modernizimin e bujqësisë, tërheqjen e investimeve, zbatimin e projekteve të hartuara gjatë planifikimit, me qëllim të rritjes së mirëqënies së qytetarëve, me theks të veçantë fermerëve, rritjes ekonomike dhe të punësimit. DBPZHR këtë plan do të mundohet ta arrijë përmes:

- Përkrahjes direkte të fermerëve - subvencionimit
- Shërbimeve këshillimore
- Implementimit të projekteve kapitale në bujqësi duke investuar në infrastrukturën bujqësore
- Zbatimin e projekteve të donatorëve dhe mbështetjes direkte në lëmin e bujqësisë për iniciativat e qytetarëve në ngritjen e cilësisë dhe sasisë së prodhimeve bujqësore.

Në kuadër të drejtorisë së BPZHR-së, nga janari janë realizuar një mori aktivitete. Ndër më kryesoret do të paraqiten të specifikuar sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

Dëmet e shkaktuara nga fatkeqësit natyrore gjatë muajit Janar 2021

Gjatë muajit janar si pasojë e reshjeve dhe vërshimeve janë shkaktuar dëme të konsiderueshme në sektorin e bujqësisë. Komisioni ka dalur në terren për evidentimin e dëmeve të shkaktuara duke u bazuar në kërkesat e fermerëve, ka përpiluar procesverbal për secilin fermer dhe ka hartuar raport përfundimtar të cilin e kemi dërguar në Ministrinë e BPZHR-së.

Në bazë të kërkesave të fermerëve të drejtuar në Drejtorinë e Bujqësisë, Kryetari i Komunës z. Smajl Latifi ka formuar komisionin me nr. Prot. 117/176 të datës 02.03.2021, për të vlerësuar dëmet e shkaktuara nga fatkeqësit e ndryshme natyrore dhe në bazë të gjendjes faktike në terren komisioni ka bërë vlerësimin në mënyrë individuale për secilin fermer duke e përpiluar nga një procesverbal.

Komisioni vlerësues, që nga data 11.01.2021 ka dalë në terren, duke mbledhur informacione dhe mbajtur shënime se në cilat zona ka pasur dëme nga reshjet e rrëmbyeshëm të shiut dhe erërave të forta.

Vlera totale e dëmit për të gjitha sektorët.

Nr.	Kultura	Vlera në €
1	Perimekulturë, Lavërtaria, Blegtoria dhe Vreshtaria	333.976.78 €



Foto 1. 2. Fotografitë e realizuara në teren, gjatë vlerësimit të dëmeve!

Kulturat që më së shumti kanë pësuar dëme nga këto fatkeqësi janë: vreshtaria (dëme në infrastrukturë, rëshqitja e dheut etj), pemëtaria (përmybtje nga uji), blegtoria (përmybtja e ujit), dëme në fushë të hapur si gruri dhe bimë organike (çaji, origano, sherbela, menta, hitha etj), ndërsa në ambientet e mbrojtura janë shkaktuar dëme tek sallata e gjelbërt, spinaqi, fidane për mbjellje dhe në infrastrukturë si në foli po ashtu edhe në konstrukcion.

Aplikimi për litër qumësht (gjashtëmujori i dytë 2020)

Ashtu siç e kemi paraparë me planin vjetor të punës, pranimi i aplikacioneve për subvencionim të qumështit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2020 për fermerët blegtor (MBPZHR hap thirrjen për aplikim, Drejtoria e BPZHR-së pranon aplikacionet dhe të njëjtat i dorëzon në Ministri për pagesë kjo thirrje ka qenë e hapur nga: 15 janar deri më 15 shkurt 2021).

Në bazë të kësaj thirrje të hapur nga MBPZHR-ja për subvencionim për litër të qumështit kanë aplikuar 89 fermerë blegtorë me total qumësht 2.276.536 litër.



Kemi mbajtuar kontakte të vazhdueshme me zyrtarët e AZHB-së lidhur me aplikacionet dhe plotësimin e tyre për aplikimet e vitit 2020. Shumë fermer kanë pasur probleme me llogari bankare ku është kërkuar nga ne që të i ndryshojmë në mënyrë që të realizojnë pagesat e tyre.

Shpërndarja e mekanizmave bujqësorë

Si vazhdimësi e projektit për përkrahje të fermerëve me mekanizëm bujqësor, gjatë kësaj periudhe janë shpërndarë pajisje për fermerët përfitues me të cilët kemi lidhur kontratë si dhe ka vazhduar shpërndarja e këtyre mekanizmave.

Në javën e parë të marsit janë shpërndarë 68 motokultivator dhe 20 laktofriz për blegtor, si dhe është bërë ndërtimi i 9 komoreve ftohëse tek fermerët përfitues.



Dhënia e pronave të paluajtshme në afatshkurtër.

Drejtoria Bujqësise, Pylltarise dhe Zhvillim Rural, në bazë të kërkesave të cilat kanë parashtruar fermerët dhe me vendim të kuvendit komunal, ka shpall ankand publik për dhënie të pronave të paluajtshme në shfrytëzim, ku janë shpallur gjashtë parcela.

Ankandi Publik ka qenë i hapur dhe janë respektuar te gjitha procedurat sipas ligjit për dhënien e tokave bujqësore komunale me qera.

Me vendimi të komisionit për shqyrtimin e këtyre ofertave, pas përfundimit të vlerësimit të ofertave janë dhënë 3 parcela për shfrytëzim si dhe komisioni i vlerësimeve ka rekomanduar që 3 parcela të tjera të rishpallen në ankandin tjetër.

Aplikimi për Pagesa e Direkte – Subvencione për vitin 2021

DBPZHR ka ndërmarr masat dhe është përgatitur me kohë për hapjen e thirrjeve nga MBPZHR për pagesa direkte (jemi kujdesur që të furnizohemi me material administrativ për të përballuar fluksin e madh të fermerëve).

Sikurse vitin e kaluar, kemi kryer të gjitha përgatitjet rreth funksionalizimit të zyrave në dy qendrat më të mëdha të komunës sonë për aplikim të fermerëve, atë në Ratkoc dhe Krushë e Madhe. Me kohë jemi pajisur me qasjet e nevojshme në të gjithë softverët që janë të lidhur me plotësim të dokumenteve që kërkohen nga MBPZHR. Poashtu leje e veçantë nga Agjencioni Kadastral i Kosovës për mundësinë e nxerrjes së dokumenteve të pronësisë edhe në këto dy qendra.

Janë inicuar procedurat dhe kemi arritur që të lidhim 7 kontrata për konsulent që do të angazhohen në DBPZHR, të cilët do të pranojnë aplikacionet e fermerëve për pagesa direkte.

E gjithë kjo me të vetmin qëllim për të ju lehtësuar fermerëve të komunës sonë këtë proces.

Sipas planifikimit të MBPZHR-së kjo thirrje ka qenë e planifikuar të hapet me 15 shkurt, por që deri më tani akoma nuk është hapur dhe ne si nivel lokal nuk kemi asnjë informatë lidhur me kohën se kur do të hapet.

Skema e granteve në MBPZHR

Pas hapjes së thirrjes nga MBPZHR për aplikim në skemën e granteve nga 15 janar deri me 1 mars kemi bashkëpunuar ngusht me kompaninë konsulente për hartim të projekteve dhe rregullim të dokumenteve për fermerët e komunës sonë. Nga kjo thirrje kane aplikuar 48 fermer për sektoret e ndryshme të bujqësisë.

- Masa 101.5 sektori i rrushit kanë aplikuar 35 fermer për ngritjen e vreshtave dhe mekanizem bujqësor,
- Masa 101.3 kane aplikuar 5 fermer blegtorë për ndërtimin e stallave për majmëri të viqave,
- Masa 101.4 kane aplikuar 4 fermer sektori i qumeshtit,
- Masa 101.6 ka aplikuar 1 fermer sektorin për veze si dhe
- Masa 103.3 kane aplikuar 3 fermer për depo për ruajtjen e prodhimeve bujqësore.

Nga të gjitha këto projekte që është aplikuar, vlera potenciale për të përfituar fermerët e komunës së Rahovecit në të gjitha sektorët është: **1,973,542 €**



Vaksinimi i bagëtive dhe qenëve shtëpiak

Për herë të parë në komunën e Rahovecit, përmes kategorisë së subvencioneve në kuadër të drejtorisë nga buxheti i vitit 2020 është bërë vaksinimi i bagëtive të trasha, bagëtive të imëta dhe qenëve shtëpiak me pronar në tërë territorin e komunës sonë.



TRAJTIMI I KAFSHEVE			
NR.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	Njësia	Sasia
1	Zënja/ kapja e qenëve endacak dhe vlerësimi për gjendjen shëndetësore	Copë	270
2	Trajtimi (kontroll, ushqim, vaksinim, dehelmetizim, identifikim - matrikulimi) i qenëve	Copë	261
3	Vaksinimi i kafshëve (qenëve endacak) kundër tërbimit	Copë	261
4	Kastrimin / Sterelizimi i qenëve endacak	Copë	261
5	Lëshimi i qenëve endacak në vendin e punës	Copë	261
6	Eutanazia (kryerja e procesit të eutanazisë, transporti dhe groposja) e qenëve	Copë	9
7	Hospitalizimi i qenëve endacak	Copë	231

Projektet e investimeve kapitale

"Ndertimi i serrave me participimin 80%-20%"

Qysh në fillim të vitit kanë rifilluar punimet në projektet ku kemi kontratë me Operatorët Ekonomik sipas kontratës "Ndertimi i serrave me participimin 80%-20%" Te dy Operoret Ekonomik që kanë kontratë me Komunën e Rahovecit janë duke i ndërtuar serrat në terren. Në Lot 1. Janë duke u ndërtuar serrat nga 3 ari dhe 10 ari, ndërsa në Lot 2. Janë duke u ndërtuar serrat nga 5 ari dhe 7 ari.

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka nxjer vendim me nr. Prot 170 dhe 171 me datën 26.04.2021, për verifikimin e serrave të ndërtuara në terren përmes projektit "Ndertimi i serrave me participimin 80%-20%", te cilët anëtarët e komisionit kane dalë ne terren për te parë gjendjen faktike të serrave pas ndertimit të tyre nga Operatori Ekonomik.

Sipas komisioneve deri më tani janë ndërtuar 105 serra nga 243 sa do te ndërtohen ne total, me sipërfaqe të ndryshme si dhe është duke vazhduar montimi i serrave sipas datës së pagesave të cilët kanë kryer fermerët dhe duke u bazuar me kushtet klimatike që po mbizotërojnë ditëve në vijim.


Ne bazë të vrojtimit të bërë kemi konstatuar se fermerët në fjalë, kanë filluar të punojnë me mbjellat e kulturave bujqësore. Në serrat e ndërtuara dominojnë këto kultura si: domate, spec, tranguj, kungullesha si dhe prodhimin e fidaneve (rasad) etj.



Ndërtimi i stallave për fermerët blegtorë

Poashtu qysh në fillim të vitit ka filluar pjesa e mbetur e ndërtimit për perfituesit stallave për perfituesit në sektorin e blegtorisë. Sipas këtij projektit janë ndërtuar 11 stalla për lope qumeshtore dhe 3 stalla për sektorin e shpezëtarisë.

Ky projekt ka përfunduar dhe tani jemi duke përgatitur procedurat për shpallje të tenderit të ri për këtë projekt si dhe hapjen e thirrjes për fermerët blegtor.



Sfidat e DBPZHR-së

Sikurse shumë sektor, edhe bujqësia është goditur në masë të madhe nga Pandemia globale Covid-19.

Fermerët tanë kanë hasur në vështirësi kryesisht në plasimin e produkteve bujqësore në treg, ku si rezultat i mos shitjes së produkteve të tyre ata kanë pasur humbje të mëdha.

Një problem tjetër që është shfaqur së fundmi është edhe mos pagesa e një pjese të fazës së dytë të subvencioneve nga ana e Ministrisë së BPZHR-së (sipas evidencave rreth 600 bujq nuk i kanë pranuar mjetet për fazën e dytë).

Problemi kryesor qëndron në atë se nuk kemi njohuri për një afat se kur do të ekzekutohen mjetet, e pikërisht tani është koha kur bujqit kanë nevojë më së shumti, pasi janë në fazën e investimeve pranverore. Ne si drejtori e bujqësisë vazhdimisht kemi adresuar kërkesën në MBPZHR, por deri më tani nuk janë përgjigjur.

Sfida në këtë periudhë janë edhe lidhja e kontratave të reja, si: Kontratat për rregullimin e rrugëve fushore, Ndërtimi i kanaleve të kullimit të tokave bujqësore, Kontrata për mekanizëm bujqësor, Kontrata për ndërtimin e stallave të reja për këtë vit, e kontrata të tjera.

PËRFUNDIM

Kjo informatë paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese dhe atyre që do të ndodhin në pjesën e mbetur të vitit 2021.

Duke u bazuar në planin e punës kemi devijim nga ajo çka ne kemi planifikuar pasi që periudha e parë që përfshinë muajt: janar, shkurt dhe mars kemi paraparë që të zhvillohet procesi i aplikimit për pagesa direkte-subvencione në kuadër të MBPZHR-se, dihet që akoma nuk është hapur thirrja dhe për këtë arsye kemi mospërmbushje të planit të punës me raportin për këtë periudhë.

Kontakti me qytetarët dhe me grupet e interesit për të trajtuar dhe zgjidhur së bashku kërkesa, nevoja dhe interesa të tyre, është i vazhdueshëm. Zyrtarët e DBPZHR-së vazhdimisht janë në terren duke takuar fermer në sektor të ndryshëm dhe duke iu ofruar këshilla të nevojshme rreth aktiviteteve agroteknike nëpër fermat e tyre. Poashtu nga fermerët kemi marr informata për pajisjet që iu nevoiten atyre, ku ne do të i përfshijmë në thirrjet për aplikim që do të hapen tremujorin e dytë.

Kemi krijuar raporte të mira me OJQ-të, me grupe të ndryshme, profesionist të fushave, me theks të veçant inxhiner të bujqësisë ku kemi pranuar këshilla, vërejtje dhe ide në mënyrë që të përmirësohemi dhe të zhvillojmë bujqësinë përditë e më mirë.

12.05.2021

Rahovec

DREJTORI DBPZHR-së

Berát Duraku





Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja c), nenit 17 dhe nenit 40 pika 2 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 12, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.1 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Propozimit të Kryetarit të Komunës me 02 Nr.488 të dt. 12.05.2021, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.05.2021 miraton këtë:

RREGULLORE

Për

Ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për vendosjen e objekteve të përkohshme në territorin e komunës së Rahovecit 01 Nr. 2558, e datës: 27.06.2014

1. Kuvendi i Komunës së Rahovecit **miraton** Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për vendosjen e objekteve të përkohshme në territorin e komunës së Rahovecit 01 Nr. 2558, e datës: 27.06.2014.
2. Neni 10, neni 11, neni 12 dhe neni 13 i Rregullores së cekur në pikën 1 të këtij propozimi do të shfuqizohen dhe largohen nga teksti bazik i kësaj rregulloreje.
3. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për vendosjen e objekteve të përkohshme në territorin e komunës së Rahovecit 01 Nr. 2558, e datës: 27.06.2014 do të jetë pjesë përbërëse e Rregullores në fuqi.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për taksa komunale hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Të njoftohen:

- **Kryetari i Komunës,**
- **Drejtorët e Drejtorive,**
- **MAPL, dhe**
- **Arkivi.**

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01-Nr. __/21
Datë:28.05.2021

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



RREGULLORE

PËR

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË
SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË (1) VIT TË PRONËS SË
PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

Maj - 2021

RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË VIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Kuvendi i Komunës në Rahovec

Në mbështetje të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 shkronja c) dhe nenit 17 paragrafi 1 shkronja c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 6 paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), konform nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.3, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.1 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur më datën: __.05.2021, miraton këtë:

RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË (1) VIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen rregullat, procedurat, kushtet dhe kriteret e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për interes publik, për periudhën më pak se një (1) vit.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga organet e komunës, personat fizik dhe juridik në territorin e Komunës së Rahovecit.

Neni 3

Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin, siç është përkufizuar në Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Parimet e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bëhet duke u bazuar në këto parime:

1.1. Parimi i ligjshmërisë - nënkupton se dhënia në shfrytëzim dhe këmbimi i pronës së paluajtshme të komunës duhet të bazohen në Kushtetutë, ligj dhe aktet e tjera nënligjore;

1.2. Parimi i efikasitetit - nënkupton se organet e komunës zhvillojnë procedurën për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, sa më shpejtë dhe sa më pak shpenzime për komunën dhe për palët, duke siguruar edhe qëllimin e dhënies së pronës për përmbushjen e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal;

1.3. Parimi i trajtimit të barabartë të palëve - nënkupton se të gjitha palët në procesin e dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, trajtohen në mënyrë të barabartë, duke shmangur çdo diskriminim ndaj palëve dhe duke vepruar në mënyrë objektive dhe të paanshme ndaj të gjithëve;

1.4. Parimi i transparencës - nënkupton se organet e komunës duhet të veprojnë me transparencë, të respektojnë dhe të garantojnë të drejtat e palëve për t'u informuar lidhur me procedurat, kushtet dhe ecurinë e dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës;

1.5. Parimi i ruajtjes dhe rritjes së vlerës së pronës publike të komunës - nënkupton se shfrytëzuesi i pronës komunale është i detyruar që pronën ta shfrytëzoj në atë mënyrë që ta ruaj vlerën e saj dhe të përdorë të gjitha masat përkatëse për rritjen e kësaj vlere;

1.6. Parimi i ruajtjes së karakteristikave dhe vlerave unike të pronës - nënkupton se shfrytëzuesi i pronës komunale, duhet ta shfrytëzoj pronën vetëm sipas destinimit të pronës duke ruajtur vlerat e saj kulturore, historike, arkeologjike, arkitekturën historike dhe çdo vlerë tjetër unike të saj, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një (1) vit

1. Komunitat mund të japin në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës për më pak se një (1) vit.
2. Pronat e paluajtshme të komunës e cila mund të jepet në shfrytëzim për më pak se një (1) vit, janë:
 - 2.1. Hapësirat publike, (parqet, sheshet, bulevardet, panot reklamuese dhe të ngjashme); (kërkesë nga Drejtori i DSHP që të futen këtu edhe parkingje)
 - 2.2. Hapësirat e shtëpisë së kulturës, kinemave, teatrove dhe terrenet rekreativo-sportive;
 - 2.3. Hapësirat publike para lokaleve;
 - 2.4. Lokalet në pronësi të komunës (që kanë karakter të përkohshëm, kiosqet, ekspozitët dhe të ngjashme);
 - 2.5. Hapësirat publike rreth vend punishteve.

3. Kompensimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një (1) vit përcaktohet me rregullore të komunës për taksa komunale.

Neni 6

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për Organizatat e shoqërisë civile

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së komunës për organizatat e shoqërisë civile për periudhën më pak se një (1) vit jepet me procedura të njëjta siç është përcaktuar me këtë rregullore.
2. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për organizatat e shoqërisë civile jepet nga një (1) ditë deri në dhjetë (10) ditë të cilat kanë për qëllim ushtrimin e veprimtarive në kuadër të kompetencave vetanake të komunës, për promovimin e vlerave kulturore, historike, arkeologjike, sportive, rinore, arkitekturën historike, e të ngjashme.
3. Organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë për qëllim ushtrimin e aktiviteteve të cekura në paragrafin 2 të këtij neni prona e paluajtshme iu jepet në shfrytëzim vetëm mbi bazën e kërkesës dhe aprovimit nga drejtori i drejtorisë, duke përjashtuar shqyrtimin e kërkesës nga ana e komisionit vlerësues.
4. Organizatat e shoqërisë civile të cilat ushtrojnë veprimtarinë apo aktivitetet rehabilituese për personat me nevoja të veçanta, prona e paluajtshme e komunës iu jepen në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit, me mundësi vazhdimi edhe për një periudhë për më pak se një (1) vit, vetëm mbi bazën e kërkesës dhe aprovimit nga drejtori i drejtorisë, duke përjashtuar shqyrtimin e kërkesës nga ana e komisionit vlerësues.

Neni 7

Kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për periudhën më pak se një (1) vit jepet, duke u bazuar në kriteret vijuese:
 - 1.1. Të jetë e regjistruar si pronë e komunës në regjistrat kadastral të pronës;
 - 1.2. Të jetë e lirë nga obligimet ndaj palëve të treta;
 - 1.3. Të mos ketë ndonjë kontest pronësor;
 - 1.4. Të jetë në pajtueshmëri me dokumentet e planifikimit hapësinor;
 - 1.5. Të plotësoj kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore;
 - 1.6. Të ketë arsyeshmërinë e interesit publik;
 - 1.7. Të ndikojë në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunë;
 - 1.8. Të ndikojë në rritjen e vlerave e diversitetit arsimor, kulturore sportiv e të ngjashme.

Neni 8

Procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën më pak se një (1) vit

1. Prona e paluajtshme e komunës jepet në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit për të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët shprehin interesim përmes një kërkesë zyrtare me shkrim.

2. Kërkesa duhet t'i drejtohet organin kompetent, drejtorisë përkatëse:
 - 2.1. Për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike ((parkingjet)parqet, sheshet, bulevardet, panot reklamuese dhe të ngjashme), kërkesa i drejtohet Drejtorisë për Shërbime Publike;
 - 2.2. Për dhënien në shfrytëzim të hapësirave të objektet kulturore, rinore dhe sportive dhe të ngjashme, kërkesa i drejtohet Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport ;
 - 2.3. Për dhënien në shfrytëzim të lokaleve në pronësi të komunës (që kanë karakter të përkohshëm, kiosqet, ekspozitë objektet dhe të ngjashme), kërkesa i drejtohet Drejtorisë për Drejtorisë për Shërbime Publike;
 - 2.4. Për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike rreth vend punishteve, kërkesa i drejtohet Drejtorisë për Shërbime Publike;
3. Prona e cila jepet në shfrytëzim mbi bazën e kërkesës së aplikuesit mund të shfrytëzohet vetëm për destinimin e kërkuar e jo për qëllime të tjera.

Neni 9

Kushtet e parapara për aplikim

1. Personat fizik dhe juridik me rastin e aplikimit për të marrë në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës duhet të bashkangjesin këto dokumente:
 - 1.1. Formularin e plotësuar me të dhënat e kërkuara nga drejtoria përkatëse;
 - 1.2. Certifikata e pronësisë;
 - 1.3. Kopja e Planit;
 - 1.4. Skica e terrenit (në raste të veçanta sipas kërkesës së Drejtorisë);
 - 1.5. Kopja e letërnjoftimit për personat fizik;
 - 1.6. Certifikata e regjistrimit të biznesit individual për personat juridik;
 - 1.7. Historiati i biznesit që aplikon;
 - 1.8. Veprimtaria që do të zhvillojë;
 - 1.9. Projekti ideor;
 - 1.10. Vërtetimi nga komuna për përmbushjen e obligimeve të tatimit në pronë dhe taksave komunale;
2. Në rast se dokumentet të cilat kërkohen në aplikimin për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës nuk janë të kompletuara, kërkesa refuzohet nga ana e drejtorisë përkatëse.

Neni 10

Formimi dhe përbërja e komisionit

1. Kryetari i Komunës nxjerr vendim për formimin e komisionit për secilën drejtori e cila në bazë të kësaj rregulloreje ka kompetencë dhe autoritet të jep në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës.

2. Komisioni do të ketë përbërje, prej tre (3) anëtarëve, ku kryesues i komisionit do të jetë zyrtari nga drejtoria së cilës i është drejtuar kërkesa për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ndërsa dy (2) anëtar mund të jenë nga drejtoritë tjera të fushave profesionale.
3. Komisioni ka për obligim që në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës të bëjë shqyrtimin e kërkesës, të konstatojë gjendjen faktike në teren, se a është në harmoni dhe përputhshmëri me arsyeshmërinë e kërkesës.
4. Pas shqyrtimit të kërkesës, komisioni duhet të bëjë raport përfundimtar dhe të rekomandojë për palën përfituese.
5. Mandati i komisionit do të jetë një (1) vit me mundësi vazhdimi edhe për një vit tjetër.

Neni 11

E drejta e ankesës

1. Pala e pakënaqur kundër procesit të vlerësimit të kërkesës ka të drejtë ankese në komisionin e ankesave pranë komunës, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
2. Kryetari i Komunës nxjerr vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave.
3. Përbërja e komisionit do të jetë prej tre (3) deri në pesë (5) anëtar, ku njëri nga anëtarët e komisionit duhet të jetë jurist, ndërsa të tjerët profesionist sipas drejtorisë përkatëse.
4. Vendimi i komisionit të ankesave për miratimin apo refuzimin e ankesës së palës është përfundimtar në procedurën administrative në komunë.
5. Komisioni për ankesa brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të ankesës bën shqyrtimin e ankesës.
6. Palët e pakënaqura me vendimin e komisionit të ankesave brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e marrjes së vendimit, mund të iniciojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.
7. Mandati i komisionit për shqyrtimin e ankesave do të jete dy (2) vite me mundësi vazhdimi edhe për dy (2) vite tjera.

Neni 12

Konflikti i interesit

1. Anëtarët e Komisionit përjashtohen nga procesi vendimmarrës nëse ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
2. Anëtarët e Komisionit vlerësues përjashtohen nga procesi vlerësues nëse ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
3. Anëtarët e Komisionit për shqyrtimin e ankesave përjashtohen nga procesi i shqyrtimit të ankesave nëse ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Neni 13
Nënshkrimi i kontratës

1. Bazuar në rekomandimit e komisionit vlerësues dhe pas kalimit të afatit të ankesës, drejtori i drejtorisë përkatëse e nënshkruan kontratën me të përzgjedhurin, në të cilën kontratë përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.
2. E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës më pak se një (1) vit, nuk mund të bartet te personat e tretë.

II. DISPOZITAT E VEQANTA

Neni 14
Mbikëqyrja e kontratës

1. Drejtoria përkatëse e bën mbikëqyrjen e realizimit të kontratës se a është duke e shfrytëzuar pala sipas kushteve të kontratës.
2. Në rast të mos përmbushjes së kontratës, apo shmangies nga qëllimi për të cilën është marr prona në shfrytëzim sipas kërkesës së palës, drejtoria përkatëse do të përgatis raport përfundimtar me të cilin do të rekomandoj Kryetarin e Komunës për shkëputje të njëanshme të kontratës.
3. Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të raportit përfundimtar të përgatitur nga drejtoria përkatëse dhe duke u bazuar në rekomandimin e dhënë do ta shkëpus kontratën në mënyrë të njëanshme, duke e njoftuar shtatë (7) ditë para ndërprerjes së kontratës palën kontraktuese.
4. Komuna është e obliguar që të publikojë listën e pronave të cilat i kanë dhënë në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
5. Publikimi i listës së pronave të paluajtshme të komunës të dhëna në shfrytëzim bëhet brenda shtatë (7) ditësh nga dita e nënshkrimit të kontratës.
6. Kontrata mund të shkëputet para afatit, me marrëveshjen e palëve kontraktuese si dhe në rastet tjera të përcaktuara me ligje në fuqi apo të përcaktuara me kontratë.

Neni 15
Mirëmbajtja e pronës së komunës

1. Të gjithë shfrytëzuesit e pronës komunale, janë të detyruar që ato t'i mirëmbajnë dhe t'i shfrytëzojnë në mënyrën e caktuar konform kontratës për shfrytëzim.
2. Personat fizik dhe juridik dhe të gjithë shfrytëzuesit e pronës së paluajtshme të komunës, janë të detyruar të kujdesen për mbrojtjen e pronës së paluajtshme, ashtu siç parashihet me këtë Rregullore.

III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen Rregulloret dhe Vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit të cilat bien ndesh me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 17 Konflikti me ligjin

Në raste konflikti dhe mos përputhje të dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe dispozitave të Ligjeve dhe akteve tjera nënligjore, do të aplikohen dispozitat e Ligjit dhe akteve tjera nënligjore që janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 18 Zbatimi

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtorët e Drejtorive të Komunës së Rahovecit.

Neni 19 Hyrja në fuqi

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në Web faqen e Komunës.

Nr.:

Afrim Dina

Data:

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Në bazë të neneve 11,12 paragrafi 2 pika c të Ligjit mbi vetëqeverisjen Lokale nr.03/ L – 40 nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit 01.Nr. 569/1 të datës 16.12.2010, 17,18,19,20 të Ligjit mbi ndërtim me e Nr.04/ L – 110 ,të datës 31.05.2012, dhe nenit 45 dhe 46 te Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve Nr.109 te datës 14.07.2006, Kuvendi Komunal Rahovec , në mbledhjen e vete të mbajtur 27 qershor 2014, miraton këtë:

R R E G U L L O R E

PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË PËRKOHËSHME NË TERRITORIN E KOMUNËS SË RAHOVECIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë Rregullore rregullohen, përcaktohen kushtet e përgjithshme dhe mënyra e vendosjes së objekteve të përkohshme në tokën ndërtimore ose në sipërfaqet publike në territorin e Komunës së Rahovecit.

Neni 2.

Me objektet e përkohshme, në kuptimin e kësaj Rregulloreje konsiderohen :

Barakat montazhe dhe demontazh(Kiosqet, Garazhet) si dhe objektet te ndërtuara para vitit 2000 të cilat janë trashëguar dhe janë me material të fortë, kiosqet për shitjen e prodhimeve ushqimore, kiosqet për shitjen e produkteve të duhanit ,kiosqet ne te cilat ushtrohen veprimtarit e ndryshme administrative (avokat, përkthyesit, fotokopjet etj.) kiosqet e sigurimit te automjeteve gazetave suvenireve, lotarive, barakat montazhe për kryerjen e shërbimeve zejtare e te tjera, instalimet për shitjen e akulloreve dhe koketerive, panotë, tabelat e reklamave, objekteve për zbavitje dhe sport, garazhet montazhe, baraka për auto larje, tavolinat e vendosura pranë trotuareve, ekspozimi i mallit para lokaleve afariste dhe kafiterive si dhe objektet e ngjashme të pa evidentuar në këtë nen.

Neni 3.

Toka ndërtimore në kuptimin të kësaj Rregullores, konsiderohet toka e cila është e përfshirë në Planin urbanistik të qytetit të Rahovecit dhe vendbanimeve tjera në Komunën e Rahovecit.

Sipërfaqet publike konsiderohet toka në pasurinë shtetërore e cila është e destinuar ose shfrytëzohet për nevojat publike shtetërore.

II. VENDOSJA E OBJEKTEVE TË PËRKOSSHME

Neni.4

Objektet nga neni 2, të kësaj Rregullore mund të vendosen, nëse i plotësojnë këto kushte:

1. Të mos zihen sipërfaqet e trotuareve të ndërtuara dhe të pa ndërtuara.
2. Që në udhëkryqet e rrugëve të mos zvogëlohet shikimi(pamja) dhe të mos rrezikohet siguria e komunikacionit.
3. Që me vendosjen e objekteve të përkohshme të mos pengohet lëvizja e lirë e këmbësorëve ne trotuaret.
4. Qe te jete ne distance te nevojshme nga rrugët publike sikurse që është përcaktuar në Ligjin mbi rrugët.
5. Që të mos pengoj shfrytëzimin normal të objekteve ekzistuese.
6. Që të mos vendosen në sipërfaqet e gjelbëruara dhe në ato të parapara për gjelbërim.
7. Që objektet të jenë të tipit montazh-demontazh, dhe mobile, përveç atyre që janë ndërtuar para vitit 2000,të cilat janë trashëguar dhe janë me material të fortë.
8. Që te mos vendosen mbi kanalet me ujerat ,fekalet, ujerat atmosferike, pusetat si dhe kanaleve të hapura.

Neni 5

Madhësinë, pamjen dhe kushtet tjera tekniko-urbanistike dhe lokacionin për vendosjen e objekteve të përkohshme si më poshtë (Baraka, Kiosqet, Garazhet, vendosja e antenave,) përcaktohen nga Drejtoria për Urbanizëm , planifikimi dhe mbrojtjen e mjedisit, duke u bazuar në rregullativën në fuqi.

Objektet tjera përveç (Baraka, Kiosqet, garazhe, vendosja e antenave) në baze të nenit 2 përcaktohen nga Drejtoria për shërbime publike , komunale .

Neni 6

Objekti i përkohshëm doemos duhet të ketë instalimet gjegjëse(Rryma, Uji), kurse nxehja duhet te kryhet ekskluzivisht me trupat e nxehjes elektrike të izoluar, varësisht nga veprimtaria.

Neni 7

Është i ndaluar destinimi i objektit të përkohshëm për nevojat tjera, përpos atyre që përcaktohen me vendimin e organit kompetent.

Është e ndaluar shitja e objekti, tjetërsimi i objektit, ndryshimi i madhësisë, pamjes dhe kushteve tjera teknike, si dhe ndërrimi i veprimtarisë, përpos me leje të veçantë të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm , planifikimi dhe mbrojtjen e mjedisit.

Shfrytëzuesit i objektit të përkohshëm është i detyruar që personalisht të kryej veprimtarinë për të cilën e ka marr lejen për vendosje , e ka regjistruar veprimtarinë, dhe ka marr lejen e punës pranë organit kompetent.

Neni 8

Kiosqet ,në kuadër të tyre nuk mund të kenë sipërfaqen e shitjes, por shitja doemos duhet të bëhet përmes pultit i cili është pjesë përbërëse e konstruksionit të objektit.

Objektet e përkohshme për shitjen e prodhimeve ushqimore doemos duhen të kenë edhe hapësirën me instalimet e ndërtuara sanitare (lavabo dhe ujë).

Neni 9

Tokë ndërtimore dhe sipërfaqet publike në territorin e Komunës së Rahovecit në të cilën mund të vendosen objektet e përkohshme janë:

1. Në anën e djathtë ,rruga " Xhelal Hajda Toni ", nga Rija deri te hyrja e zjarrfikësve:
Kiosqet e duhanit, kiosqet e shtypit, ëmbëltoret, shitja e prodhimeve ushqimore , zyrat përkthyesve, zyrat e avokatëve dhe të noterëve etj.
2. Në anën e djathtë të rrugës "8 Dëshmorët e Pashtrikut" nga vendi përballë hyrjes në oborrin e Komunës, deri te fabrika e masave plastike:
Kiosqet e duhanit, kiosqet e shtypit, zyrat e përkthyesve, zyrat e avokatëve dhe të noterëve etj.
3. Në anën e majte te Qendra e qytetit:
Kiosqet e duhanit, kiosqet e shtypit
4. Në anën e djathtë ,rruga " Avdullah Bugarit" nga soliteri deri te zyrat e KEDS:
Kiosqet e duhanit, kiosqet e shtypit ,shitja e prodhimeve ushqimore,orëpunues etj.
5. Në anën e majte te rrugës" Xhelal Hajda Toni " deri te Kosova Petroli:
Kiosqet e duhanit, kiosqet shtypit ,shitja e prodhimeve ushqimore , orë punues , etj .
6. Në anën e majtë të rrugës" Xhelal Hajda Toni " deri te kthesa e rrugës "Skender Rexhepit",
Kiosqet e duhanit, kiosqet e shtypit, ëmbëltoret, shitja e prodhimeve ushqimore , xhampersi , rregullimi i televizorve etj .
7. Në platonë, te kisha ortodokse në Rahovec:
Kiosqet e duhanit , shitja e prodhimeve ushqimore etj.
8. Në sipërfaqet publike dhe pronat shtetërore në qytetin e Rahovecit apo në lokalitetet tjera te cilët nuk gjenden në këtë nenë (Kushtet urbanistike-teknike i cakton:

Drejtoria për Urbanizëm , planifikimi dhe mbrojtjen e mjedisit..

Hapësira e lire për trotuar prej pikës 1-7 duhet të jetë e mjaftueshme për lëvizjen e këmbësorëve dhe që është e paraparë me kushtet urbanistike – teknike .

III. DHENJA E TOKES NE SHFRYTEZIM TE PERKOHSEM

Neni 10

Toka ose sipërfaqja publike për vendosjen e objekteve nga neni 2 i kësaj rregulloreje jepet në bazë të vendimit të Drejtoria për shërbime publike , komunale .

Neni 11.

Toka në pronësi shtetërore jepet në shfrytëzim të përkohshëm me përparësi parashtruesve të kërkesave që plotësojnë këto kushte:

- Kur shfrytëzuesi i tokës nuk ka në pronësi lokal tjetër afarist.
- Kur nuk është në marrëdhënie pune.
- Kur veprimtarin zejtare ose veprimtarinë tjetër ta kryej si veprimtarin të vetme(mos të merret me veprimtarit tjera).
- Të ketë leje për pune(veprimtaria të jetë e regjistruar pranë organit kompetent).
- Personalisht të shfrytëzoj lokalin për veprimtarinë e përcaktuar me Lejen e lëshuar nga organi Kompetent.
- Jashtë qytetit në vendbanimet rurale parashtruesit e kërkesave duhet të kërkojnë kushtet urbanistike – teknike nga Drejtoria për Urbanizëm , planifikimi dhe mbrojtjen e mjedisit.

Neni 12

Pas marrjes së vendimit mbi lejimin e tokës për shfrytëzimin dhe lëshimin e kushtet urbanistike – teknike për vendosjen e objektit të përkohshëm, shfrytëzuesi është i obliguar që të lidh kontratë me Drejtoria për shërbime publike , komunale në afat, kohëzgjatje për 1 vit, me qëllim të rregullimit të çështjes së pagesës së kontributeve për shfrytëzim e tokës shtetërore-publike sipas Rregullores komunale mbi tarifat dhe taksat.

Parashtruesve të kërkesave i lejohej vendosja e tavolinave, frigoriferëve dhe sendeve të ngjashme para lokaleve hoteliere dhe lokaleve tjera afariste sipas afatit të përcaktuar në kërkesën e palëve, por jo në afat më të gjatë se 1 (një) vit.

Neni 13

Toka ose sipërfaqe publike në shfrytëzim ditor mundë të jepen me vendim të Drejtoria për shërbime publike , komunale.

IV. DHËNJA E LEJES

Neni 14

Leje për shfrytëzimin e përkohshëm të parcelës tokësore-shtetërore e lëshon, revokon Drejtoria për shërbime publike komunale .

- I. Kërkesës për dhënien e lejes për vendosjen e objekti të përkohshëm, pala obligohet ti bashkëngjisë këto dokumente:
 1. Fletë posedimi-certifikata original (jo më e vjetër se 6 muaj)
 2. Kopja e planit origjinal.
 3. Kopja e veprimtarisë së regjistruar pranë organit përgjegjës kompetent.
 4. Kushtet tekniko-urbanistike, që lëshon Drejtoria për Urbanizëm , planifikim dhe mbrojtjen e mjedisit
 5. Vërtetimi nga enti për punësim që nuk është në marrëdhënie pune,
 6. Skicën e objektit të përkohshëm (përshkrim).
 7. Vërtetimi nga tatimi në pronë, jo më e vjetër se 30 ditë.
 8. Vërtetimi nga financa mbi kryerjen e obligimeve financiare.

- II. Kërkesën për vazhdimin e kontratës, palët e parashetrojnë prej 1-30 Janar për çdo vit vijues, pala kërkesës duhet t,ia bashkëngjit këto dokumente:
 1. Fletë posedimi- (kopja)
 2. Kopja e planit - (kopja)
 3. Vërtetim i ri tatimi në pronë (jo më e vjetër se 30 ditë)
 4. Vërtetimi i ri nga financa mbi kryerjen e obligimeve financiare

V. E DREJTA PËR ANKESË

Neni 15.

Kundër çdo aktvendimi apo aktit tjetër të nxjerr nga organi përgjegjës kompetent nga neni 10 dhe në bazë të rregullativës , pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në një afat prej 30 dite.

Ankesa i drejtohet Kryetarit të komunës, përmes organit kompetent nga neni 10, nga dita e marrjes në dorëzim të aktvendimit.

Ankesa e paraqitur kundër aktvendimit të Drejtorisë për Drejtoria për ,shërbime publike , komunale , mbi refuzimin e kërkesës mbi mbylljen ose largimin e objektit të përkohshëm nuk e ndalon ekzekutimin e tij.

Neni 16.

Leje për vendosjen e objektit të përkohshëm përmban:

1. Shënimet mbi shfrytëzimin e objektit,
2. Shënimet themelore mbi objektin (lloji, madhësia, veprimtaria etj.)
3. Shënimet mbi tokën-sipërfaqen në të cilën vendoset objekti
4. Afati mbi vendosjen e objektit dhe afati i vazhdimin të lejes.

Neni 17

Leja për vendosjen e objektit të përkohshëm pushon të prodhoj efekte juridike në qofte se objekti nuk vendoset në vendin e përcaktuar me lejen dhe Kushtet tekniko-urbanistike nga organi përgjegjës kompetent.

Afati për vendosjen e objektit të përkohshëm, në vendin e përcaktuar duhet të jetë brenda 30 dite nga dita e lëshimit të lejes

Neni 18.

Inspektori i ndërtimtarisë në bashkëpunim me inspektori komunal bëjnë kontrollin me rastin e vendosjes së objektit të përkohshëm.

Pas vendosjes së objektit, por para fillimit të shfrytëzimit të tij bëhet kontrolli përfundimtar me qëllim të vërtetimit, se a është respektuar leja e lëshuar nga organi kompetent.

Kontrollin e bën organet nga alineja 1 e këtij neni.

VI. LARGIMI OSE MBYLLJA E OBJEKTIT

Neni 19

Inspektori i ndërtimtarisë në bashkëpunim me inspektorin komunal në bazë të aktvendimit të Drejtoris për shërbime publike bën mbylljen, largimin dhe prishjen e objekteve të përkohshme dhe konfiskimin e mallit para lokaleve në këto raste :

1. Nëse ka skaduar afati i parashikuar mbi vazhdimin e Lejes për vendosjen e objektit.
2. Nëse vjen gjer te shkëputja ose ndërprerja e kontratës mbi shfrytëzimin e tokës.
3. Nëse shfrytëzuesi i objektit të përkohshëm ekzistues në afatin që është caktuar me këtë vendim.
 - Nuk paraqet kërkesën për përputhshmërinë e objektit të përkohshëm me kushtet të parashikuara me këtë vendim ose kërkesa e tij refuzohet plotfuqishëm.
 - Nuk paguan kompensimin për shfrytëzimin e tokës për kohën me të gjatë se 4 muaj.
 - Nëse nuk respektohet sipërfaqja e përcaktuar nga Drejtoria përkatëse .
4. Nëse ia jep në shfrytëzim personit tjetër.
5. Nëse Komunës i duhet për interesat e përgjithshëm shoqëror.

Neni 20

Me Aktvendimin nga Drejtoria për shërbime publike caktohet afati për mbylljen ose largimin e objektit (varësisht nga lloji i objektit) i cili nuk mund të jetë më i shkurt se 8 ditë dhe më i gjatë se 30 ditë.

Neni 21.

Në qoftë se shfrytëzuesi i objektit të përkohshëm nuk e largon objektin në afatin e caktuar, largimi do të bëhet në mënyrë të dhunshëm nga organet kompetente (neni 18 alineja 1 e këtij vendimi) dhe të gjitha shpenzimet e shkaktuara do të bien në barë të shfrytëzuesit të objektit.

VII. KOMPENZIMI PËR SHFRYTZIMIN E TOKËS

Neni 22.

- I. Për vendosjen e objekteve të përkohshme paguhet kompensimi vjetor për shfrytëzimin e tokës dhe atë:
 - a) Për vendosjen e objekteve në pronësinë shtetërore
 - b) Për vendosjen e objekteve në pronësinë individuale (kërkohet leje mbi vendosjen)
 - c) Për vendosjen e tavolinave, mallit dhe sendeve tjera që shërbejnë për ushtrimin e veprimtarive.
- II. Kompensimi për shfrytëzimin e tokës në pronësinë shtetërore paguhet sipas Rregullores komunale për taksa dhe tarifa në fuqi, për objektet si më poshtë:
